



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT  
(Përfundimtar)**

**PËR**

**MBIKËQYRJEN E ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL  
GJATË PROCESIT TË DEKLARIMIT TË STATUSIT TË PUNËSIMIT**

**BASHKIA KRUJË**

**Tiranë, Mars 2016**

## RAPORT

### **Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil, gjatë procesit të deklarimit të statusit të punësimit Bashkia Krujë.**

#### Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështjete të nenit 11, pika 1, nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të Mbikëqyrjes, miratuar me Vendimin nr.19, datë 11.03.2015, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes tematike në institucionin e Bashkisë Krujë, me Vendimin nr.103, datë 23.09.2015, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Krujë”*.

Pas implementimit të reformës administrativo-territoriale, organet e qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve të qershorit 2015, janë organizuar dhe funksionojnë bazuar në ligjin nr. 115/2014 *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*.

Në rastin konkret, shtrirja territoriale e Bashkisë së Krujës, si organ i qeverisjes vendore, përfshin edhe disa njësi të qeverisjes vendore, të cilat më parë kanë qënë të organizuara si institucione më vete, si Bashkia Fushë Krujë, Komuna Nikël, Komuna Thumanë, Komuna Bubq dhe Komuna Cudhi, të cilat, në bazë të ligjit nr. 30/2015 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar”*, janë organizuar si njësi administrative, struktura dhe organika e të cilave, do të jenë pjesë e strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë.

Në Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”*, Kreu III, *“Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve”*, pika 1, përcaktohet se bashkia është trashëgimtari ligjor i njësive të qeverisjes vendore që janë shkrirë në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ, të njësive të qeverisjes vendore që janë shkrirë. Më tej, në Kreun IV të këtij akti nënligjor, *“Transferimi i personelit”*, parashikohet se marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet njësive që janë shkrirë dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj.

Në këto rrethana, kryerja e mbikëqyrjes në këtë institucion, me objekt plotësimin e kushteve ligjore të statusit të punësimit, të parashikuara në nenin 67 të ligjit 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit*

nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", është shtrirë edhe në njësitë administrative, pjesë përbërëse të strukturës së institucionit Bashkia Krujë.

Sipas Programit të Mbikëqyrjes, nr. 650/1 prot., datë 23. 09. 2015, të miratuar dhe njoftuar institucionit me shkresën nr. 650/2 prot., datë 23.09.2015 "Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes", grupi i punës, u paraqit në institucion në datën 28. 09. 2015.

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion është me karakter tematik dhe përfshin verifikimin e procesit të deklarimit të statusit të punësimit të nëpunësve, të cilët, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, kanë qenë të punësuar në pozicione të shërbimit civil.

Në vijim të procesit dhe në përfundim të afatit që i është lënë institucionit për të paraqitur observacionet përkatëse, rezulton se, projekt raporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe drejtuesi i njësisë përgjegjëse, me shkresën nr. 454 prot., datë 05.02.2016, "Dërgim projekt raporti", regjistruar pranë Komisionerit me nr. 650/4 prot., datë 09.02.2016, shoqëruar me disa vërejtje, të cilat kanë gjetur pasqyrim në raportin përfundimtar.

Për sa më sipër, është përmbushur detyrimi ligjor për të njohur subjektin e mbikëqyrur me projekt raportin dhe janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, vlerësoj se duhet të vijoj me shqyrtimin e përmbajtjes së raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, në përfundim të këtij procesi.

### **Qëllimi i mbikëqyrjes**

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dalta në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë përgjegjëse dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

## **Objekti i mbikëqyrjes**

Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.

1. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
  - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil, në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion.
  - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit Civil*”, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit.
  - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune.  
Rastet e refuzimit të deklaramit të statusit të nëpunësit civil.
  - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklaramit të statusit të punësimit të punonjësve.
  - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklaramit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.
2. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (*njësisë përgjegjëse*), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

## **Metodologjia e mbikëqyrjes**

Nga grupi i mbikëqyrjes është zgjedhur si metodë pune, verifikimi në subjekt i dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet e personelit, në arkivin e institucionit, si dhe në sektorin e financës, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë të shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, nga grupi i punës ka kryer veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht, është realizua një takim me Kryetarin e Bashkisë Krujë dhe me Përgjegjësen e Sektorit të Burimeve Njerëzore, gjatë të cilit kanë diskutuar mbi objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe kanë rënë dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej tu vihej në dispozicion grupit të mbikëqyrjes për verifikim.

- Janë verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës së institucionit.
- Janë verifikuan procedurat e rekrutimit dhe dosjet individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme që duhet të plotësojnë nëpunësit për pranimin në shërbimin civil.
- Janë verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil, lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës si niveli arsimor, përvoja në punë, etj.
- Është administruar dokumentacioni i kërkuar, ku përfshihen listë prezencat e punonjësve për periudhën shkurt 2014 dhe për periudhën, gusht 2015.
- Janë verifikuan aktet e deklaramit të statusit të nëpunësit civil për të gjithë nëpunësit e bashkisë, të lëshuara nga njësia përgjegjëse.

Konstatimet e grupit të mbikëqyrjes janë të materializuara si anekse më vete (*Aneksi 1 dhe Aneksi 2*), të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij raporti.

### **Përmbajtja e raportit:**

#### **I. Si është kuptuar ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), në lidhje me procesin e deklaramit të statusit të punësimit.**

##### ***a) Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes, në Bashkinë Krujë.***

Institucioni i Bashkisë Krujë është krijuar dhe ka funksionuar mbi bazën e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*", (i ndryshuar), i cili e përcakton atë, si njësi të qeverisjes vendore, e si e tillë në bazë të neneve 2 dhe 4, pika "b", e ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, përfshihet në fushën e shërbimit civil. Menaxhimi i shërbimit civil në këtë institucion, është realizuar mbi bazën e strukturave organizative të miratuara nga Këshilli Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*", (i ndryshuar), i cili, në nenin 32, gërma "ç", përcaktonte se, struktura dhe organika e administratës së bashkisë, miratohet nga Këshilli Bashkiak.

Nga analiza e dokumentacionit që është vënë në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", (i ndryshuar), (datë 26.02.2014), Bashkia Krujë, ka qenë e organizuar dhe ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 3, datë 13.02.2014 të Këshillit Bashkiak "*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë dhe funksioneve të saj për vitin 2014*".

Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, institucioni i mbikëqyrur kishte gjithsej **135** pozicione pune, nga të cilat, vetëm **34** pozicione, ishin pjesë e shërbimit civil.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, paraqiten në raportin e mëposhtëm:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, është **1** pozicion pune, që zë **3** % të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të shërbimit civil, të cilat i përkasin kategorisë "Drejtor Drejtorie", (paga, II-b).
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **9** pozicione pune, që zënë **26** % të vendeve të punës, në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve pjesë e shërbimit civil, pozicione pune të cilat i përkasin kategorisë "Përgjegjës Sektori/Kryeinspektor/Administrator", (paga, III-b).
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **24** pozicione pune, që zënë **71** % të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, pozicione pune të cilat i përkasin kategorisë "Specialist/Inspektor", (paga, III-b).

Nga kontrolli i ushtruar, si dhe nga materialet që na janë vënë në dispozicion nga njësia e burimeve njerëzore rezulton se numri i pozicioneve të punës<sup>1</sup>, mënyra e plotësimit të pozicioneve që janë pjesë e shërbimit civil në momentin e realizimit të mbikëqyrjes dhe pjesa që zënë këto pozicione në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës në shërbimin civil, paraqitet si më poshtë:

- 10 pozicione pune, që zënë **29** % të vendeve të punës, në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë të plotësuara nga nëpunës që janë rekrutuar si nëpunës civilë sipas procedurave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".
- 18 pozicione pune që zënë **53** % të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë të plotësuara nga nëpunës të emëruar me emërim të përkohshëm, të cilët data 26.02.2014, që është edhe momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, i ka gjetur këta punonjës, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.
- 3 pozicione pune që zënë **9** % të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë të plotësuara nga nëpunës që janë rekrutuar si nëpunës civilë sipas procedurave të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.
- 2 pozicione pune që zënë **6** % të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar me nëpunës pas fillimit

---

<sup>1</sup>Struktura organizative për vitin 2015 miratuar me vendimin nr. 3 datë 16.01.2015 të këshillit të Bashkisë Krujë ndryshon nga struktura organizative e vitit 2014 miratuar me vendimin nr. 3 datë 13.02.2014, sepse në këtë strukturë janë shtuar 2 pozicione pune në shërbimin civil ajo e Drejtorit të Planifikim Teritorit dhe Menaxhimit të Pronave dhe ajo e Specialistit të Planifikim Teritorit.

të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me akte emërimi të përkohshme.

- *1 pozicione pune* që zë 3 % të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, vende të lira.

***b) Plotësimi i kushteve ligjore për të përfutuar statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.***

Nisur nga fakti që institucioni i Bashkisë Krujë është pjesë e shërbimit civil, atëherë deklarimi si nëpunës civilë ekzistues për çdo punonjës të këtij institucioni, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- *pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;*
- *pika 4, “Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;*
- *pika 6, “Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.*

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 ”Për nëpunësin civil”, Kreu II ”Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, pika 1, është përcaktuar se: “*Nëpunës civilë*”, sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013”Për nëpunësin civil” dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Dispozitat e përmendura më sipër, përbëjnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për deklarimin e statusit të punësimit, pas verifikimit të procedurës së punësimit për gjithë nëpunësit që mbanin pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, grupi i mbikëqyrjes ka verifikuar dhe analizuar të gjitha

materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, siç mund të përmendim:

- ✓ organigramën dhe strukturën e institucionit, e cila ka qenë në fuqi në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit;
- ✓ listë prezencën dhe listë pagesën e muajit shkurt 2014;
- ✓ dokumentacionin e plotë që vërteton procedurën e marrjes në punë, përfshirë aktin e emërimit apo kontratën e punësimit;
- ✓ librezën e punës, si dokument që vërteton hyrjen në punë dhe kohëzgjatjen e punësimit;
- ✓ si dhe të dhënat profesionale dhe çdo të dhënë tjetër lidhur me marrëdhënien e punës në shërbimin civil.

Pas analizës së situatës, lidhur me statusin e punësimit të punonjësve të këtij institucioni, bazuar në strukturën analitike që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, më poshtë po paraqesim gjendjen, sipas aspekteve të ndryshme të trajtuara në këtë rast dhe problematikave të hasura.

***b. 1) Nëpunës, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar në ligjin nr .8549/1999 ”Statusi i nëpunësit civil”.***

Nga analiza e dokumentacionit të administruar, konstatohen **10** raste, nëpunës që kanë kryer funksione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të cilët janë të rekrutuar sipas procedurave të konkurrimit, sipas kërkesave të ligjit të kohës nr. 8549, datë 11.11.1999 ”Statusi i nëpunësit civil”.

Nga këqyrja e akteve të administruara dhe përmbajtja e tyre, rezulton se në **9** raste janë respektuar procedurat ligjore të kërkuara nga ky ligj, duke e finalizuar këtë proces me nxjerrjen e aktit të emërimit dhe atë të konfirmimit si nëpunës civil, pas përfundimit të periudhës së provës, sipas përcaktimeve të nenit 13 dhe 14, të ligjit nr. 8549/1999 ”Statusi i nëpunësit civil”, ndërsa në 1 rast nuk janë zbatuar këto procedura. Bëhet fjalë për punonjës S. Merlika.

Konstatohet se, për këtë kategori punonjësish, Sektori i Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse e ngarkuar nga ligji për të formalizuar aktin e deklarimit të statusit të punësimit, ka vepruar si më poshtë:

- në **7** raste, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit në kategorinë “nëpunës civil”, me vendimet përkatëse në muajin qershor 2014.

Këtu, bëhet fjalë për punonjësit;

1. \*\*\*\*\* , i konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjëse në Sektorin Juridik”.
2. \*\*\*\*\* , i konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin “Inspektor i Kulturës dhe Arsimit”.



3. \*\*\*\*\*, e konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor i Kulturës dhe Arsimit*”.
4. \*\*\*\*\*, e konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin “*Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit Teritorit*”.
5. \*\*\*\*\*, e konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin “*Përgjegjëse e Sektorit të M.M.T.P*”.
6. \*\*\*\*\*, e konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor i Gjellbërimit*”.
7. \*\*\*\*\*, e konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor i Pastrimit*”

**Konkluzion:** Në këtë rast Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse ka vepruar drejt në lidhje me deklarinimin e statusit të punësimit si “*nëpunës civilë*”, për këtë kategori punonjësish, pasi ata janë emëruar në përputhje me kërkesat e ligjit të kohës, kur kanë filluar marrëdhënien e punës në shërbimin civil.

Aktet që dokumentojnë këtë proces, janë të evidentuara në tabelën **Aneks nr. 1** “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*”, Bashkia Krujë.

- në 3 raste nuk është nxjerrë akti i deklarimit të statusit të punësimit, me pretendimin se këto pozicione pune nuk konsiderohen në vijim, si pozicione pune, pjesë e shërbimit civil.

Këtu, bëhet fjalë për punonjësit;

1. \*\*\*\*\*, i konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Planifikimit të Territorit*”, me aktin nr. 7, datë 30.10.2006.
2. \*\*\*\*\*, e konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin “*Inspektore e Ndihmës Ekonomike*”, me aktin nr. 7, datë 30.10.2006.
3. \*\*\*\*\*, i konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin “*K/inspektor i Tatim Taksave*”, me aktin nr. 7, datë 30.10.2006, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, mbante pozicionin e audituesit të brëndshëm, sipas Urdhërit nr. 28, datë 10.09.2012, aktualisht, sipas aktit nr. 16, datë 01.04.2015, mban pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Prokurimeve*”, i cili është i barazvlershëm me pozicionin e inspektorit.

Në kuptim të nenit 2, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, këto pozicione pune, kanë qenë dhe vijojnë të mbeten pjesë e shërbimit civil, në kushtet kur realizojnë një funksion publik dhe kanë karakteristikat që përcakton ligji për një pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Për më tepër, përfshirja e këtyre pozicioneve në shërbimin civil është e përcaktuar edhe në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”.

Konkretisht, në pikën 9 të këtij akti nënligjor, klasifikohen pozicionet e shërbimit civil të kategorisë ekzekutive, sipas natyrës së pozicionit në **a) grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm** dhe **b) grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm**.

Sipas pikës 12 të këtij akti nënligjor, grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm përcaktohen në Lidhjen nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e tij. Më tej, Lidhja nr. 3 "Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës", në kolonën e parë, ka renditur grupin e specialistëve të institucioneve të administratës publike, që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, bazuar mbi profesionet përkatëse.

Në këtë renditje, rezulton se, në nëngrupin që i përket ndarjes me numër rendor 18, ku përfshihet pozicioni i specialistit të zhvillimit të territorit, në funksion të sistemit të mbrojtjes së tokës dhe 28, ku bëjnë pjesë pozicioni i punës specialist i ekonomisë për planifikimin buxhetor, menaxhimin financiar, prokurimet, kontabilitetin, investimet, llogaritjen e kostove për mbledhjen e taksave, për vlerësimin e dëmeve etj, përcaktohet në mënyrë të shprehur emërtesa e pozicioneve të punës, si pozicione që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil.

Ndërkohë, konstatohet se të tre këta punonjës, nuk e plotësojnë kriterin arsimor për të qenë pjesë e shërbimit civil, e më tej, për të përfituar nga të drejtat që i njeh neni 67, i ligjit aktual, që rregullon shërbimin civil, për t'u bërë pjesë e kategorisë së nëpunësve civilë.

**Konkluzion:** Nga sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

- ✓ Pozicioni i punës "Specialist në Sektorin e Planifikim Territorit", aktualisht i plotësuar nga punonjësi \*\*\*\*\* dhe pozicioni i punës "Inspektor i Ndihmës Ekonomike", aktualisht i plotësuar nga punonjësja \*\*\*\*\*, duhet të trajtohen si pozicione pjesë e shërbimit civil.

Në kushtet e mungesës së arsimit të kërkuar për pozicionin e punës, nga punonjësit në fjalë, njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, duhet të përfundojë procesin e deklaramit të statusit të punësimit për këta punonjës dhe të vendosë refuzimin e statusit të nëpunësit civil, duke ndërprerë marrëdhënien e punës me shërbimin civil, për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor.

- ✓ Në të njëjtën mënyrë duhet të veprohet edhe në rastin e pozicionit të punës "Inspektor në Sektorin e Prokurimeve", i cili duhet të trajtohet dhe të plotësohet në përputhje me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

Ndërkohë, rezulton se ky pozicion aktualisht është i plotësuar nga nëpunësi \*\*\*\*\*, i cili duke filluar që nga momenti i rekrutimit, me ligjin e kohës, nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil", është përfshirë në shërbimin civil në kundërshtim me ligjin, pasi ka konkurruar në pozicionin e Kryeinspektorit, ndërkohë që kishte kryer vetëm studimet në nivelin e parë, "Bachelor", të arsimit të lartë.

Për më tepër, fillimi i efekteve juridike të ligjit të ri, e ka gjetur këtë nëpunës në pozicionin e audituesit të brendshëm, i cili është një pozicion i rregulluar me ligj të veçantë mbi auditimin dhe kërkon prej punonjësve që e ushtrojnë këtë detyrë, që të përmbushin kërkesa specifike të nivelit arsimor dhe të fushës së studimeve, të cilat në momentin e deklarimit të statusit të punësimit nuk përmbushen nga punonjësi në fjalë.

Në kushte të tilla, njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duhet të përfundojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësin dhe të vendosë refuzimin e statusit të nëpunësit civil, duke ndërprerë marrëdhënien e punës me shërbimin civil, për mosplotësim të kriterit arsimor.

***b. 2) Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.***

Nga analiza e materialeve të verifikuara, rezulton se në **18** raste, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, janë emëruar punonjës me akte emërimi të përkohshme, ose me kontratë pune, duke mos respektuar procedurat ligjore të rekrutimit, sikurse përcaktohej në nenin 13 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”.

Për periudhën, nga momenti i lidhjes së marrëdhënies së punës, deri në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, këta punonjës janë trajtuar sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit, këta punonjës, janë trajtuar si më poshtë:

- për **12** prej tyre, është realizuar deklarimi i statusit të punësimit, mbështetur në përmbajtjen e pikës 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, për shkak se, sipas njësisë së personelit, këta punonjës kanë qenë të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më tepër se 1 vit.

Bëhet fjalë për rastet e renditura më poshtë, sipas pozicioneve të punës dhe emrave të punonjësve:

1. Pozicioni i punës, “*Përgjegjëse në Sektorin Ekonomik*”, ku ishte punësuar nëpunësja \*\*\*\*\*;
2. Pozicioni i punës, “*Inspektore në Sektorin Ekonomik*”, ku ishte punësuar nëpunësja \*\*\*\*\*;
3. Pozicioni i punës, “*Inspektore për Problemet e Barazisë Gjinore*”, ku ishte punësuar nëpunësja \*\*\*\*\*;
4. Pozicioni i punës, “*Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore*”, ku ishte punësuar nëpunësja \*\*\*\*\*;
5. Pozicioni i punës, “*Përgjegjës në Sektorin e Tatim Taksave*”, ku ishte punësuar nëpunësi \*\*\*\*\*;
6. Pozicioni i punës, “*Përgjegjës i Shërbimit Social*”, ku ishte punësuar nëpunësi \*\*\*\*\*;

7. Pozicioni i punës, “*Inspektore e Shërbimit Social*”, ku ishte punësuar nëpunësja \*\*\*\*\*;
8. Pozicioni i punës, “*Përgjegjës në Sektorin e Arsim Kulturës*”, ku ishte punësuar nëpunësi \*\*\*\*\*;
9. Pozicioni i punës, “*Inspektore në Sektorin e Planifikim Territorit*”, ku ishte punësuar nëpunësja \*\*\*\*\*;
10. Pozicioni i punës, “*Drejtor Drejtoria e Shërbimeve*”, ku ishte punësuar nëpunësi \*\*\*\*\*;
11. Pozicioni i punës, “*Inspektor Pyjesh*”, ku ishte punësuar nëpunësi \*\*\*\*\*;
12. Pozicioni i punës “*Inspektor Veteriner*”, ku ishte punësuar nëpunësi \*\*\*\*\*;

Pas verifikimit dhe analizës së akteve të punësimit të këtyre punonjësve, nisur nga momenti i fillimit të marrëdhënies së tyre të punës dhe asaj financiare, rezulton i vërtetë fakti se këta punonjës në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kanë qenë të punësuar për një periudhë më shumë se një vit, në ato pozicione pune, pjesë e shërbimit civil.

**Konkluzion:** Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore, ka vepruar drejt në lidhje me deklarinimin e statusit të punësimit si nëpunës civilë për këtë kategori punonjësish, me aktet përkatëse, të cilat kanë dalë në muajin qershor, 2014.

Shprehimisht, aktet që dokumentojnë këtë proces, janë të përmendura në tabelën *Aneksi nr. 1*, “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*”, i ndryshuar, Bashkia Krujë.

- për 6 raste, nuk është deklaruar statusi i punësimit, me pretendimin se këto pozicione pune nuk konsiderohen pjesë e shërbimit civil.

Bëhet fjalë për rastet e renditura më poshtë, sipas pozicioneve të punës dhe emrave të punonjësve:

1. Pozicioni i punës “*Inspektor në Sektorin Ekonomik*”, ku ishte punësuar nëpunësja \*\*\*\*\*;
2. Pozicioni i punës “*Inspektor i Tatim Taksave*”, ku ishte punësuar nëpunësi \*\*\*\*\*;
3. Pozicioni i punës “*Inspektor i Tatim Taksave*”, ku ishte punësuar nëpunësi \*\*\*\*\*;
4. Pozicioni i punës “*Inspektor i Tatim Taksave*”, ku ishte punësuar nëpunësi \*\*\*\*\*;
5. Pozicioni i punës “*Inspektor në Sektorin e Shërbimit Social*”, ku ishte punësuar nëpunësja \*\*\*\*\*;
6. Pozicioni i punës “*Inspektor në Sektorin e Arsim dhe Kulturës*”, ku ishte punësuar nëpunësi \*\*\*\*\*;

Në këto raste, problemi duhet të trajtohet në dy këndvështrime, së pari nga kualifikimi i pozicioneve të punës në raport me shërbimin civil dhe së dyti, nëse punonjësit që u gjenden në këto pozicione, i plotësojnë kriteret ligjore për t'u konsideruar si nëpunës civilë.

Në lidhje me pozicionet e punës, në këtë rast, ashtu si e kemi përmendur edhe më sipër, rezulton se veprimi i njësisë përgjegjëse, nuk është realizuar në përputhje me kërkesat specifike që rregullojnë marrëdhëniet e punësimit në lidhje me këto pozicione pune.

Në kuptim të nenit 2, të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, këto pozicione pune janë funksione që ushtrojnë autoritet publik dhe si të tillë, kanë qenë dhe vijnë të jenë pjesë e shërbimit civil. Për më tepër, përfshirja e këtyre pozicioneve në shërbimin civil, mbështetet edhe në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave "*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*".

Konkretisht, në pikën 9 të këtij akti nënligjor, klasifikohen pozicionet e shërbimit civil të kategorisë ekzekutive, sipas natyrës së pozicionit në **a) grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm**; dhe **b) grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm**.

Ndërkohë, sipas pikës 12 të këtij akti nënligjor, grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm, përcaktohen në Lidhjen nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e tij.

Më tej, Lidhja nr. 3 "*Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës*", në kolonën e parë, ka renditur grupin e specialistëve të institucioneve të administratës publike, që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, bazuar mbi profesionet përkatëse.

Ndërsa, në lidhje me punonjësit që kanë qenë në këto pozicione pune në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit aktual për nëpunësin civil, ashtu si do ta trajtojmë në rubrikën më poshtë, ata nuk i plotësojnë kushtet për të qenë nëpunës civilë, pasi nuk përmbushin kriterin arsimor. Më hollësisht ky aspekt do të trajtohet në vijim të raportit.

**Konkluzion:** Nga sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse duhet t'i trajtojë këto pozicione si pjesë e shërbimit civil dhe duhet të ndërpresë marrëdhënien e punës, për punonjësit që nuk e plotësojnë kriterin arsimor në këtë rast, ashtu si do të trajtohet në vijim të kësaj rubrike, ku bëhet fjalë për verifikimin e këtyre rasteve.

### ***b. 3) Pozicione pune të zëna me procedurë konkurrimi, sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar .***

Për **3** (tre) raste, konstatohet se është realizuar procesi i deklarimit të statusit si nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 1392, datë 29.07.2015, ndërkohë që rezulton se këto raste janë plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurrimit, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me ligjin, pasi përmbyllja e procesit të konkurrimit, duhej të trajtohej sipas neneve 23, 24 e vijues të ligjit nr. 152/2013

“Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe jo sipas përcaktimeve të dispozitës transitore, që është e materializuar në nenin 67, të këtij ligji.

Konkretisht, bëhet fjalë për rastet si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, *”Inspektore në Sektorin Ekonomik”*, (emëruar në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive, me aktin nr. 29 prot., dt.04.09.2014);
2. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, *”Inspektore e Marrëdhënieve me Publikun në Sektorin Juridik ”*, (emëruar në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive, me aktin nr. 43 prot., dt. 03.10.2014);
3. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, *”Inspektor i Prokurimeve Publike”*, (emëruar në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive me aktin nr. 21 prot., dt. 04.06.2014).

**Konkluzion.** Në lidhje me 3 pozicionet e plotësuara nëpërmjet konkurrimit, vlerësohet se duhet të vijojnë procedurat e kërkuara nga ligji, për të përfunduar procesin, të cilat në këtë rast janë:

- ✓ Vlerësimi i punës;
- ✓ Trajnimin në Shkollën e Administratës Publike (ASPA).

Pas plotësimit të këtyre procedurave, duhet të vijoj procesi, sipas kërkesave të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 *”Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Ndërkohë, vlen të theksohet në këtë moment, konstatimi i grupit të mbikëqyrjes në lidhje me përfshirjen e gabuar në shërbimin civil, të pozicioneve të punës, *“Specialist në Sektorin e Arsimit dhe Kulturës”* dhe *“Specialist në Sektorin e Shërbimeve në Infrastrukturë”*, pas verifikimit, të natyrës konkrete të punës që kryenin punonjësit gjatë veprimtarisë së tyre, pavarësisht emërimit të pozicionit.

Nga analiza e përmbajtjes konkrete të kompetencave që ushtrojnë, apo proceseve konkrete të punës, që kryhen në këto pozicione (si p.sh., *Specialist në Sektorin e Arsimit dhe Kulturës në rastin konkret kryen shërbime brenda ambienteve të bibliotekës së qytetit apo Specialist në Sektorin e Shërbimeve në Infrastrukturë është personi i cili kryen shërbimet e mirëmbajtjes së institucionit të Bashkisë Krujë*) nxirret përfundimi se ato janë njësi publike direkte të shërbimit, që nuk kryejnë funksione për ushtrimin e autoriteti publik, nuk marrin pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave dhe në monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, apo sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre, prandaj si të tilla nuk duhet të trajtohen si pjesë e shërbimit civil.

Duke u nisur nga sa analizuam më sipër, Komisioneri vlerëson se njësia përgjegjëse ka vepruar drejt, kur nuk ka nxjerr aktin e deklarimit të punësimit për nëpunësin \*\*\*\*\*, sepse pozicioni i punës që ajo mban, nuk është pjesë e shërbimit civil, pavarësisht se, me aktin nr. 7, datë 30.10.2006, ajo është konfirmuar si nëpunëse civile në bazë të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 *“Statusi i nëpunësit civil”*.

Nëpunësja në fjalë duhet të vijojë marrëdhënien e punës me institucionin, sipas rregullave që parashikon ligji në këtë rast që është Kodi i Punës, i RSH.

Gjithashtu, nga ana e njësisë përgjegjëse, duhet të fillojë menjëherë puna për hartimin e përshkrimeve të punës, me qëllim që të bëhet e mundur ndarja reale e pozicioneve që përfshihen në shërbimin civil, nga ato të nivelit ndihmës administrativ, duke u bazuar në detyrat konkrete që ato zhvillojnë.

***b. 4) Vende pune të plotësuara nga nëpunës që janë emëruar me akte emërimi të përkohshme, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.***

Pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, konstatohet se, në këtë institucion, në 2 raste, janë marrë në punë punonjës me akte emërimi të përkohshme.

Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

1. \*\*\*\*\* , emëruar në pozicionin "Inspektore e Tatim Taksave", me aktin nr. 17, datë 01.04.2015;
2. \*\*\*\*\* , emëruar në pozicionin " Inspektor i Prokurimeve Publike", me aktin nr. 16, datë 01.04.2015.

**Konkluzion:** Në këto rrethana arrihet në konkluzionin se, aktet e emërimit në pozicionet e përmendura më sipër, kanë dalë në kundërshtim me ligjin pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në bazë të nenit 22 dhe 23 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimit. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull (*pika 4, e nenit 23, të ligjit në fjalë*), është absolutisht i pavlefshëm.

Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se njësia përgjegjëse, për rregullimin e situatës, duhet të revokojë aktet e emërimit për punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.

Pozicionet e punës, "Inspektor i Tatim Taksave" dhe " Inspektor i Prokurimeve Publike", duhet të shpallen pozicione të lira, dhe të plotësohen nëpërmjet procedurës së konkurrimit, sipas kërkesave të neneve 22, 23, 24, e vijues të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar në përputhje me dinamikën dhe nevojat sipas strukturës së vitit 2016.

***b. 5) Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të paplotësuara (vakant), në momentin e mbikëqyrjes.***

Gjatë verifikimit është konstatuar se, në Bashkinë Krujë, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, ka qenë 1 pozicion pune i paplotësuar, dhe konkretisht pozicioni:

- ✓ Përgjegjës infrastrukture

Në lidhje me këtë pozicion, ai duhet të shpallet si i lirë dhe të vijojnë procedurat e rekrutimit në përputhje me ligjin për nëpunësin civil si dhe në koherencë me strukturën aktuale të institucionit, për vitin 2016.

**3) Rastet e refuzimit të statusit të punësimit, në cilësinë e nëpunësit civil, për shkak të mospërmbushjes së kriterëve ligjore, sipas nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil, i ndryshuar.**

Në këtë rubrikë, po përmbledhim rastet e konstatuara gjatë mbikëqyrjes, ku janë evidentuar mangësi të plotësimit të kriterëve ligjore, nga ana e punonjësve të gjendur në marrëdhënie pune, me pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit aktual për nëpunësin civil, ç`ka i pengon ata, për të qenë pjesë e shërbimit civil.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, në këtë institucion janë konstatuar **8** raste të tilla, pasi punonjësit e gjendur në këto pozicione, nuk përmbushin kriterin e nivelit arsimor.

Bëhet fjalë për punonjësit e përmendur më poshtë sipas emrit dhe pozicionit të punës:

1. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 7, datë 30.10.2006, në pozicionin "Inspektore në Sektorin Ekonomik";
2. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. (pa nr. protokollin), në datën 16.04.2003, në pozicionin "Inspektor në Sektorin e Tatim Taksave";
3. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 08, datë 01.06.2009, në pozicionin "Inspektor në Sektorin e Tatim Taksave";
4. \*\*\*\*\*, emëruar me kontratë pune, datë 20.07.2011, në pozicionin "Inspektor në Sektorin e Tatim Taksave";
5. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 5, datë 02.10.2006, në pozicionin "Inspektore në Sektorin e Shërbimit Social".
6. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 05, datë 02.10.2006, në pozicionin "Inspektore në Sektorin e Shërbimit Social".
7. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 03, datë 13.02.2014, në pozicionin "Inspektor në Sektorin e Arsimit dhe Kulturës".
8. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 09, datë 16.03.2001, në pozicionin "Specialist në Sektorin e Planifikim Territorit".

Në lidhje me këto raste, konstatohet se, këta punonjës nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë, për shkak të nivelit arsimor, pasi janë me arsim të mesëm.

Niveli arsimor, është një kërkesë e posaçme për pranimin në shërbimin civil, e përcaktuar si një prej kërkesave të përgjithshme, e parashikuar në shkronjën "e" të nenit 21, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se, një kandidat për nëpunës civil, duhet të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, që në këtë rast është arsim i lartë.



Në kushtet kur, punonjësit nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, duke u bazuar në pikën 6, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhet të vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës.

**Konkluzion:** Në këtë rast, Komisioneri çmon se, njësia përgjegjëse, duhet të vijojë procesi me përfundimin e marrëdhënies së punësimit, për këta punonjës, ndërkohë që pozicionet e punës që ata kanë plotësuar duhet të trajtohen si pjesë e shërbimit civil, ashtu si është analizuar në rubrikën përkatëse, më sipër.

Për këtë arsye, njësia përgjegjëse, duhet të vendosë menjëherë përfundimin e marrëdhënies së punësimit, duke evidentuar faktin e mospërmbushjes së kriterit arsimor për punonjësit në fjalë, e pas kësaj, pozicionet që lirohen duhet të shpallen të lira, për t'u plotësuar me konkurrin, në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 22, e vijues të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe me dinamikën e zhvillimit të administratës për vitin 2016, në kushtet e implementimit të mëtejshëm të reformës territoriale.

Në observacionin e dërguar nga institucioni në lidhje me këtë rast, ngrihet pretendimi se disa nga punonjësit e Bashkisë Krujë, që janë të listuar më sipër, aktualisht janë larguar nga shërbimi civil, për arsye se nuk plotësonin kriterin e nivelit arsimor, sipas rekomandimeve të lëna në projekt raport. Në lidhje me këtë pretendim Komisioneri konstatoi se, bashkëlidhur observacionit, nuk janë paraqitur prova, të cilat të mbështesin argumentin e parashtruar.

Për këtë arsye, verifikimi i këtyre rasteve, do të realizohet gjatë kohës që i është lënë në dispozicion njësisë përgjegjëse, për rregullimin e ligjshmërisë në vendimin përfundimtar të paralajmërimit, për të rregulluar situatën e shërbimit civil.

#### ***4) Pasqyrimi i procesit të deklarimit të statusit të punësimit në dosjen e personelit***

##### ***a. Dosja e Personelit***

Në zbatim të programit, nga grupi i punës janë verifikuar dosjet e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administruar në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) dhe sipas kërkesave të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit”.

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, është konstatuar se janë të përfshira dokumente me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas Lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur aktit nënligjor, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, rezultoi se, në dosjet personale të nëpunësve, administrohet,

- ✓ dokumenti i identifikimit (*fotokopje e letërnjoftimit*);
- ✓ dokumenti mbi gjendjen civile (*certifikata e gjendjes familjare*);
- ✓ dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (*fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave*),
- ✓ dokumentet që vërtetojnë fillimin e marrëdhënieve të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*);
- ✓ dokumenti i vërtetimit të gjendjes gjyqësore, apo certifikata e kontrollit shëndetësor (*Raporti Mjekësor*), si dhe
- ✓ aktet që provojnë procesin e deklarimit të statusit të punësimit.

Konstatohet se në Bashkinë Krujë dhe njësitë e qeverisjes vendore, Bashkia Fushë-Krujë, Komunat Thuman, Nikël, Bubq e Cudhi, pjesë përbërëse e Bashkisë Krujë, në **19** raste mungon vërtetimi i gjendjes gjyqësore (*Dëshmia e Penalitetit*) dhe në **31** raste mungon vërtetimi i gjendjes shëndetësore (*Raporti Mjekësor*).

Domosdoshmëria e pajisjes me këto akte rrjedh nga kërkesat e nenit 21, pika “ç” dhe “d”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të cilat në përmbajtjen e tyre kanë kërkesat e përgjithshme që duhet të përmbushë një kandidat që të jetë pjesë e shërbimit civil, i cili duhet të jetë i padënuar dhe në gjëndje të mirë shëndetësore për të kryer detyrat funksionale.

Gjendja e dosjes së personelit është e materializuar në *Aneksin nr. 2, “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/82013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil”*.

Në lidhje me mangësitë e konstatuara, rekomandohet që të plotësohen dosjet e personelit në përputhje me kërkesat ligjore.

#### ***b. Regjistri i personelit***

Regjistri i personelit është një dokument që duhet të krijohet sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Në kushtet kur, ende nuk është bërë funksional Regjistri Qendror i Personelit, që sipas ligjit administrohet nga Departamenti i Administratës Publike, në një mënyrë specifike, sipas përcaktimeve të bëra në një akt nënligjor të veçantë, rezulton se të dhënat që përmban regjistri i personelit në institucion, pasqyrojnë gjendjen reale të burimeve njerëzore në këtë subjekt.

Në institucionin e mbikëqyrur, u konstatua se dosjet e personelit, janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

**II. Situata e shërbimit civil, në njësitë e qeverisjes vendore, të cilat, për shkak të implementimit të reformës territoriale, aktualisht janë pjesë e Bashkisë Krujë, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar).**

***1. Bashkia Fushë - Krujë, aktualisht Njësia Administrative Fushë-Krujë***

Në momentin e fillimit të këtij procesi mbikëqyrje, Bashkia Fushë-Krujë, aktualisht Njësia Administrative Fushë-Krujë, ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 57, datë 19.02.2014, të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë për vitin 2014”.

Në strukturën organizative të kësaj njësie, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, kishte gjithsej **92** pozicione pune, nga të cilat, **27** pozicione ishin pjesë e shërbimit civil.

Klasifikimi dhe ndarja e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, është bërë në këtë mënyrë :

- Pozicione pune të nivelit të mesëm drejtues janë **4**, që zënë **15 %** të numrit të përgjithshëm të vendeve të punës. Këto pozicione i përkasin kategorisë “Drejtor Drejtorie”; paga II-b.
- Pozicione pune të nivelit të ulët drejtues janë **3**, që zënë **11 %** të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të punës dhe i përkasin kategorisë “Përgjegjës Sektori/Administrator”; paga III-b.
- Pozicione pune të kategorisë ekzekutive, janë **20**, që zënë **74 %** të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të punës. Këto pozicione i përkasin kategorisë “Specialist/Inspektor”; paga III-b.

Vërehet se, në strukturën e institucionit nuk janë të ndara pozicionet e shërbimit civil nga pozicionet e tjera të punës, që nuk janë pjesë e shërbimit civil, ç`ka bën të nevojshme një klasifikim dhe ndarje të tyre, duke u nisur nga natyra e punës, kompetencat e funksionit, raporti që këto pozicione kanë në lidhje me ushtrimin, ose jo të autoritetit publik, apo janë thjesht, njësi publike direkte të shërbimit.

Kështu p.sh., në strukturë gjendet emërtesa “Jurist”, e cila duke u nisur nga natyra e punës, kompetencat dhe mënyra e ushtrimit të këtyre kompetencave, në raport me legjislacionin e shërbimit civil, duhet të përfshihet në kategorinë e pozicioneve ekzekutive dhe të ketë

emërtesën “*Specialist*” dhe jo të përdoret emërtimi, sipas kualifikimit arsimor që duhet të ketë personi i cili do të punësohet në këtë pozicion.

Ky arsyetim gjen mbështetje edhe në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” dhe më konkretisht të Lidhjes nr. 3 “*Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës*”, e cila, është pjesë e këtij vendimi, ku përcaktohet se, emërtimi i pozicioneve të kategorisë ekzekutive, bëhet mbi bazën e klasifikimit të pozicioneve të punës, sipas profesioneve, apo sipas grupeve të ngjashme të punës.

Ky përfundim duhet të mbahet parasysh në të ardhmen, kur të hartohen strukturat pasardhëse, në mënyrë që të ketë një vijë të qartë ndarje, mes pozicioneve që përfshihen në shërbimin civil dhe njësive publike direkte të shërbimit, të cilat nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Po kështu, në momentin e miratimit të strukturës, duhet të ketë përfunduar procesi i hartimit të përshkrimit të punës me qëllim që të bëhet e mundur kjo ndarje, duke u bazuar në detyrat konkrete që kryejnë punonjësit në këto pozicione pune.

***1. a) Plotësimi i kushteve ligjore për të përfutuar statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, në Bashkinë Fushë-Krujë, aktualisht Njësia Administrative Fushë-Krujë.***

Institucioni i Bashkisë Fushë - Krujë, ka qenë pjesë e shërbimit civil edhe sipas legjislacionit të mëparshëm që rregullonte shërbimin civil. Në këtë vështrim, sipas nenit 13 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”, mënyra e vetme e rekrutimit ka qenë konkurrimi. Por, pavarësisht këtij detyrimi ligjor, nga analiza e materialeve të verifikuara, rezulton se, **19** pozicionet e punës, të cilat pavarësisht se ishin pjesë e shërbimit civil, janë zënë me punonjës të punësuar me akte emërimi të përkohshëm, ose me kontrata pune, duke mos i respektuar në këtë mënyrë kërkesat ligjore.

Në kushtet e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, këta punonjës, megjithëse të marrë në punë në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të mëparshëm, kanë përfutuar nga dispozita e nenit 67 të ligjit të ri, dhe sipas rastit, kanë fituar statusin e nëpunësit civil, apo atë të nëpunësit civil në periudhë prove, për shkak të ligjit.

Konkretisht, nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe nga këqyrja e akteve të punësimit, rezulton se:

- në **14** raste, për punonjësit ekzistues, të cilët në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kanë pasur një periudhë punësimi më tepër se 1 vit në atë pozicion, njësia përgjegjëse me të drejtë, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, si nëpunës civilë, me aktet respektive, të datës 10.04.2014.

Bëhet fjalë për punonjësit, sipas emrit dhe pozicioneit të punës, si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Drejtor i Burimeve Njerëzore",
2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Juriste",
3. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Drejtoresh e Financës",
4. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Inspektore Pagash",
5. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Inspektore Kontrolli në Drejtorinë e Tatim Taksave",
6. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Inspektor Taksash në Drejtorinë e Tatim Taksave",
7. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Drejtoresh në Drejtorinë e Shërbimit Social",
8. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Inspektore e Ndihmës Ekonomike",
9. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Inspektore e Ndihmës Ekonomike",
10. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës",
11. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Inspektor në Drejtorinë e PKZH. Territorit",
12. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Specialiste e Pronave në Drejtorinë e MMT",
13. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Specialist Veteriner",
14. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Specialist Pyjesh".

➤ në 5 raste, punonjës ekzistues, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, kanë pasur një periudhë më pak se 1 vit, në atë pozicion pune dhe bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Inspektore në Drejtorinë e Financës", me aktin nr.130, datë 04.09.2013;
2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Inspektore Licencimi", me aktin nr. 131, datë 04.09.2013;
3. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Inspektor në Drejtorinë e Tatim Taksave", me aktin nr. 53, datë 15.04.2013;
4. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Veteriner Pranë Drejtorisë së MMT", me aktin nr.16, datë 29.01.2014;
5. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Drejtor i Urbanistikës", me aktin nr. 132, datë 06.09.2013

Nga verifikimi i akteve administrative të administruara në dosjet përkatëse të personelit, rezultoi se në 2 raste,

- ✓ Njësia përgjegjëse me të drejtë ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit, si nëpunës civilë në periudhë prove, me Vendimin nr. 15, të datës 10.03.2014 dhe më pas, në datën 08.04.2015 me aktin nr. 22, ka nxjerrë aktin e deklaramit si nëpunës civil për nëpunësin \*\*\*\*\* në pozicionin "Drejtor Urbanistike";

- ✓ për nëpunësin \*\*\*\*\*; në pozicionin e Veterinerit në Sektorin e MMTokës, ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit, si *nëpunës civilë në periudhë prove*, nr. 36 datë 10.03.2014 dhe në datën 08.04.2015, me aktin nr. 20, ka nxjerrë aktin e konfirmimit si nëpunës civil, akte të materializuara në anekset, që janë pjesë e këtij raporti.

Ndërsa për 3 rastet e tjera, nuk është deklaruar statusi i punësimit, pasi pozicionet e punës, nuk janë vlerësuar si pjesë e shërbimit civil. Bëhet fjalë për pozicionet e punës:

- ✓ *Inspektor në Drejtorin e Financës*”, plotësuar nga nëpunësja \*\*\*\*\*; emëruar me aktin nr. 130, datë 04.09.2013;
- ✓ *“Inspektor Licencimi në Drejtorin e Tatim Taksave”*, plotësuar nga nëpunësi \*\*\*\*\*; emëruar me aktin nr. 131, datë 04.09.2013;
- ✓ *“Inspektor në Drejtorinë e Tatim Taksave”*, mbajtur nga nëpunësi \*\*\*\*\*; emëruar me aktin nr. 53, datë 15.04.2013.

Siç e kemi analizuar më sipër në material, në mënyrë analoge, nënvizojmë se këto pozicione pune, duhet të konsiderohen si pozicione pune pjesë e shërbimit civil, pasi kryejnë funksione publike dhe kanë karakteristikat dalluese të shërbimit civil, sipas parashikimeve ligjore.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se tre punonjësit e mësipërm, janë punësuar me akte emërimi të përkohshme, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit në fjalë, ata kanë qenë në këto pozicione për më pak se një vit kohë, prandaj në bazë të nenit 67, pika 4, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ata duhej të përfitonin statusin e nëpunësit civil në periudhë prove.

Ndërkohë, konstatohet se punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*; e plotësojnë kriterin arsimor në këto pozicione, ndërsa punonjësi \*\*\*\*\*; ka kryer nivelin e parë të arsimit të lartë *“Bachelor”*, ç’ka do të thotë se nuk e përmbush kriterin arsimor për pozicionin që ka plotësuar.

Aktet që dokumentojnë këtë proces, janë të evidentuara në tabelën **Aneks nr. 1**, *“Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*”, Njësia Administrative Fushë - Krujë.

**Konkluzion:** Nga sa u analizua më sipër, Komisioneri vlerëson se,

- ✓ njësia përgjegjëse e Bashkisë Fushë - Krujë, aktualisht Njësi Administrative, në 16 raste ka vepruar drejt, në zbatimin e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojë statusin e*

*nëpunësit civil, sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kur ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për nëpunësit, e analizuar në këtë rubrikë të raportit, si nëpunës civilë, apo nëpunës civilë në periudhë prove.*

- ✓ njësia përgjegjëse e Bashkisë Fushë – Krujë, pa të drejtë, nuk ka deklaruar statusin e punësimit, në kategorinë e nëpunësit civil, në periudhë prove, për 2 punonjësit e analizuar, më sipër, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, pasi ka interpretuar gabim ligjin, duke mos i vlerësuar pozicionet e punës ku ata punojnë, si pjesë e shërbimit civil.

Për këtë arsye, njësia përgjegjëse, duhet të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil në periudhë prove për këta punonjës, sipas pozicioneve të punës që kanë pasur në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit aktual për nëpunësin civil. Më tej, pas plotësimit të kërkesave të pikës 4, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse e Bashkisë Krujë, duhet të kujdeset për kryerjen e ciklit të trajnimit të detyrueshëm pranë Shkollës së Administratës Publike (ASP), e më pas të realizojë vlerësimin e punës dhe të nxjerrë aktin e konfirmimit, ose jo të nëpunësit civil, sipas kërkesave të ligjit.

- ✓ njësia përgjegjëse, e Bashkisë Krujë, duhet të ndërpresë marrëdhënien e punës për nëpunësin \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 53, datë 15.04.201, në pozicionin “Inspektor në Drejtorinë e Tatim Taksave”, pasi nuk plotëson kriterin arsimor.

Pozicioni i punës inspektor kërkon të kesh kryer studimet e larta edhe në nivelin “Master Shkencor”.

- ***Raste të rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.***

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, janë verifikuar emërimet në pozicionet e shërbimit civil, të kryera pas datës 26.02.2014, që është edhe momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Gjatë verifikimit në subjektin e kontrolluar, është konstatuar se në pozicionin e punës “Shef i Sektorit të Arsimit, Kulturës dhe Sporteve”, (pozicion ky, që ka karakteristikat dhe elementët e një funksioni që përfshihet në shërbimin civil) me aktin nr. 52, dt. 20. 03. 2014, është emëruar punonjësja \*\*\*\*\*, e cila më parë ka kryer detyrat në pozicionin e punëtorese së mirëmbajtjes (pozicion ky, që nuk përfshihet në shërbimin civil). Në këtë rast, nga ana e institucionit është konsideruar një lëvizje e brendshme e personelit dhe nuk kanë realizuar procedura konkurrimi.

Nga ana e Komisionerit në këtë rast është konstatuar se, njësia përgjegjëse nuk ka realizuar një procedurë të rregullt konkurrimi për plotësimin e pozicionit “Shef i Sektorit të Arsimit, Kulturës dhe Sporteve”.

**Konkluzion:** Në kushtet kur, bëhet fjalë për një akt emërimi në shërbimin civil, pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pa respektuar procedurën e konkurrimit, në bazë të pikës 4, të nenit 23, të këtij ligji, jemi para një akti absolutisht të pavlefshëm, prandaj si i tillë, akti duhet të revokohet menjëherë dhe marrëdhënia e punës në fjalë, duhet të ndërpritet.

Ky pozicion pune, mund të shpallet pozicion i lirë, nëse kjo vlerësohet e arsyeshme/nevojshme nga njësia e burimeve njerëzore, në përputhje me mundësitë dhe nevojat sipas strukturës pasardhëse.

Po kështu, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në Bashkinë Fushë - Krujë, konstatohen edhe 2 raste të tjera, kur janë punësuar persona me akte emërimi të përkohshëm, pa respektuar më parë procedurat e rekrutimit që kërkohen nga legjislacioni i shërbimit civil.

Bëhet fjalë për punonjësit e mëposhtëm, sipas pozicioneve përkatëse :

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Inspektor Personeli”, me aktin nr. 618, datë 06.03.2014;
2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Inspektore e Buxhetit dhe Aseteve”, me aktin nr. 94 datë 25.06.2015;

Në lidhje me këto raste, Komisioneri konstaton se është bërë observacion nga institucioni, duke pretenduar se këta punonjës i plotësojnë kushtet dhe janë trajtuar si nëpunës civil.

Nga ana e Komisionerit, u analizua ky pretendim dhe u arrit në përfundimin se, këta punonjës janë emëruar në pozicionet përkatëse të punës, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe për këtë arsye, në kuptim të nenit 23, pika 4, të këtij ligji, aktet e emërimit të sipër përmendura për emërimin e nëpunësve në fjalë, janë absolutisht të pavlefshme, pasi këta punonjës nuk kanë hyrë në shërbimin civil, sipas një procesi të rregullt ligjor.

**Konkluzion:** Nga sa u analizua më sipër, arrihet në përfundimin se, aktet e emërimit në këto pozicione, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në bazë të nenit 22 dhe 23 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat për një procedurë të rregullt konkurrimit. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është veprim administrativ absolutisht i pavlefshëm.

Në këtë rast,

- ✓ i kërkohet njësisë përgjegjëse, që për rregullimin e situatës, të revokojë aktet e emërimit për punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* dhe të ndërpresë marrëdhënien e tyre të punës me institucionin.



- ✓ Pozicionet e punës “*Inspektor Personeli*” dhe “*Inspektor i Buxhetit dhe Aseteve*”, mund të shpallen pozicione të lira, nëse kjo vlerësohet e arsyeshme/nevojshme nga njësia e burimeve njerëzore, në përputhje me mundësitë dhe nevojat sipas parashikimit të strukturës së vitit 2016.

➤ ***Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të paplotësuara (vakant)***

Gjatë verifikimit u konstatua se, në Bashkinë Fushë-Krujë, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, janë **5** pozicione pune të paplotësuara, dhe konkretisht:

- ✓ *Specialist i Arkiv Protokollit dhe Informacionit;*
- ✓ *Drejtor i Tatim Taksave;*
- ✓ *Inspektor në Sektorin e Planifikimit të Territorit;*
- ✓ *Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës;*
- ✓ *Specialist i Kulturës dhe Arsimit dhe Sportit.*

Komisioneri vlerëson se, këto pozicione pune, mund të shpallen si pozicione të lira, nëse kjo vlerësohet e arsyeshme/nevojshme nga njësia e burimeve njerëzore, në përputhje me mundësitë dhe nevojat sipas strukturës pasardhëse.

**2. Komuna Thumanë, aktualisht Njësia Administrative Thumanë**

Komuna Thuman, aktualisht Njësia Administrative Thumanë, është një subjekt i përfshirë për herë të parë në fushën e shërbimit civil, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në momentin e fillimit të mbikëqyrjes, kjo njësi e qeverisjes vendore, ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 2, datë 19.01.2015 të Këshillit të Komunës “*Për miratimin e strukturës organizative të Komunës Thumanë për vitin 2015*”. Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, kjo njësi vendore, kishte gjithsej **81** pozicione pune, nga të cilat, vetëm **17** pozicione pune, ishin pjesë e shërbimit civil.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, ndahen në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **6** pozicione pune, që zënë **35 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, dhe i përkasin kategorisë “*Përgjegjës Sektori/ Kryeinspektor/ Administrator*”; paga III-b.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **11** pozicione pune, që zënë **65 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e

shërbimit civil, të cilat i përkasin kategorisë ekzekutive, “*Specialist/Inspektor*”; paga III-b.

**2.a) Plotësimi i kushteve ligjore për të përfitur statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij në Njësinë Administrative Thumanë.**

Mbikëqyrja në këtë subjekt është realizuar mbi bazën e akteve të administruara në dosjen individuale të nëpunësve, listë prezencës së punonjësve për periudhën shkurt 2014, dhe në strukturën e miratuar nga Këshilli i Komunës Thumanë, me Vendimin nr. 2, datë 19.01.2015, të Këshillit të Komunës, “*Për miratimin e strukturës organizative të Komunës Thumanë, për vitin 2015*”.

Kjo për faktin se nga ana e njësisë përgjegjëse të këtij institucioni nuk ishte kryer asnjë veprim në zbatim të detyrimit ligjor për të deklaruar statusin e punësit për punonjësit që gjeti në pozicione të shërbimit civil, fillimi i efekteve juridike të ligjit aktual për nëpunësin civil.

Mbështetur në të dhënat e administruara, si dhe nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4, të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, rezulton se situata paraqitet si më poshtë:

***i. Nëpunës civil që plotësonin kriteret e ligjit për të qenë pjesë e shërbimit civil;***

Në këtë grupim përfshihen punonjësit, sipas pozicioneve përkatëse të punës, të renditur si më poshtë:

➤ në 2 raste, konstatohen punonjës ekzistues që në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar kanë qenë të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më tepër se 1 vit, bëhet fjalë për punonjësit;

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Jurist*”, me aktin nr. 20, dt.29.07.2011;
2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Inspektore Veterinere*”, me aktin nr. 14/1, dt. 04.07.2007.

➤ në 3 raste, konstatohen punonjës që, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kanë qenë të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më pak se 1 vit dhe bëhet fjalë për punonjësit:

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Përgjegjëse e Zyrës së Tatim Taksave*”, emëruar me aktin nr. 53, datë 02.09.2013;
2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Administratore e Zyrës së Ndhmës Ekonomike*”, emëruar me kontratë në datën 06.01.2014;

3. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist Pyjesh*”, me aktin nr. 78, dt.01.10.2013;

**Konkluzion:** Nga sa është pasqyruar më sipër, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Komunës Thumanë, nuk ka nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit për këta punonjës të cilët i plotësojnë kriteret për të qenë pjesë e shërbimit civil dhe për këtë arsye, i kërkon njësisë përgjegjëse të Bashkisë Krujë, që për 5 raste, të nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë dhe nëpunës civilë në periudhë prove, për atë kategori punonjësish, të analizuar më sipër.

Për nëpunësit civilë në periudhë prove, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që të zbatohen kërkesat e nenit 24 të ligjit për nëpunësin civil, që rregullon këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil.

Aktet që dokumentojnë këtë proces, janë të evidentuara në tabelën *Aneks nr. 1*, “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*”, Njësia Administrative Thumanë.

***ii. Raste të konstatuara me parregullsi në mënyrën e rekrutimit dhe që nuk plotësojnë kriterin arsimor.***

- në 1 rast, sipas aktit të emërimit të administruar në dosjen individuale të punonjësit, bëhet fjalë për nëpunësin \*\*\*\*\*, konstatohet se është ngritur në detyrë, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit, duke mos zbatuar procedurat e konkurrimit, të përcaktuara në lidhje me zhvillimin e sistemit të karrierës. Nisur nga akti i emërimit nr. 80, datë 04.10.2013, kur ky punonjës është emëruar si inspektor i tatim taksave dhe sipas listë prezencës që mbulon muajin shkurt 2014, nga data 01.02.2014, deri në datën 28.02.2014, rezulton se ky punonjës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit aktual për nëpunësin civil, ushtronte detyrën e inspektorit të tatim taksave, pranë Komunës Thumanë, situatë e cila ka vazhduar deri në daljen e aktit nr. 121, datë 16.06.2014, kur ai është emëruar në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Zyrës së Financës*”.

Nga ana e Komisionerit, në këtë rast është konstatuar se, njësia përgjegjëse nuk ka deklaruar fillimisht statusin e punësimit për këtë punonjës dhe më tej, nuk ka realizuar një procedurë të rregullt konkurrimi për plotësimin e pozicionit “*Përgjegjës i Zyrës së Financës*”.

**Konkluzion:** Në kushtet kur, bëhet fjalë për një akt emërimi në shërbimin civil, pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pa respektuar procedurën e konkurrimit, në bazë të pikës 4, të nenit 23, të këtij ligji, jemi para një akti absolutisht të pavlefshëm, prandaj si i tillë, akti duhet të revokohet menjëherë dhe marrëdhënia e punës në fjalë, në lidhje me këtë pozicion pune duhet të ndërpritet, e punonjësi të sistemohet në një pozicion që i përgjigjet nivelit të tij në shërbimin civil, atje ku e ka gjetur fillimi i efekteve juridike të ligjit aktual për nëpunësin civil.

Në lidhje me deklarinimin e statusit të punësimit për këtë punonjës, njësia përgjegjëse e Bashkisë Kruje, duhet të realizojë verifikimin e përmbushjes së kërkesave për vendin e punës nga ana e këtij punonjësi, pasi nga dokumentacioni i administruar në dosje, Komisioneri nuk arrin që të nxjerrë një konkluzion të saktë. Në dosje mungon diploma në këtë rast dhe evidentohet vetëm një vërtetim, në përmbajtjen e të cilit thuhet se ai ka kryer studimet në fakultetin Ekonomik Elbasan, duke mos specifikuar nivelin arsimor.

Në këto rrethana, njësia përgjegjëse, pas verifikimit të këtij fakti, duhet të shprehet për statusin e punësimit të këtij punonjësi, në pozicionin e inspektorit të tatim taksave.

Ky pozicion pune, mund të shpallet pozicion i lirë, nëse kjo vlerësohet e arsyeshme/nevojshme nga njësia e burimeve njerëzore, në përputhje me mundësitë dhe nevojat sipas strukturës pasardhëse.

- në 7 raste, sipas akteve të emërimit të administruara në dosjen individuale të punonjësve, konstatohet se ata i kanë filluar marrëdhëniet e punës, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit, duke mos respektuar procedurat e rekrutimit, e për pasojë aktet e emërimit të tyre në pozicionet përkatëse të punës, vlerësohen të nxjerra në kundërshtim me ligjin.

Ky qëndrim bazohet në detyrimin ligjor, që kërkon për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në bazë të nenëve 22, 23 e vijues të tij, të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Në këtë rast, bëhet fjalë për punonjësit që do të renditen më poshtë, sipas pozicioneve përkatëse:

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Inspektore e Buxhetit"
2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Inspektor i Zyrës së Tatim Taksave"
3. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Inspektor i Zyrës së Tatim Taksave"
4. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Juriste"
5. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Administrator i Zyrës së Ndihmës Ekonomike"
6. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Përgjegjës i Zyrës së AMMT"
7. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Inspektor i Arsimit dhe Kulturës"

**Konkluzion:** Nga sa u analizua me sipër për këto raste, Komisioneri vlerëson se, aktet e emërimit në këto pozicione pune, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, apo për çdo rast që ka lidhje me zhvillimin e karrierës në shërbimin civil, në bazë të nenit 22 dhe 23 e vijues të tij, që janë dispozitat që rregullojnë ngritjen në detyrë, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat për një procedurë të rregullt konkurrimi dhe çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, konsiderohet si veprim administrativ absolutisht i pavlefshëm.

Në këtë rast, i kërkohet njësisë përgjegjëse, që për rregullimin e situatës, të revokojë aktet e emërimit për punonjësit e sipër përmendur dhe të ndërpresë marrëdhënien e tyre të punës me institucionin.

Pozicionet e punës që mbaheshin nga këta punonjës, mund të shpallen pozicione të lira, nëse kjo vlerësohet e arsyeshme/nevojshme nga njësia e burimeve njerëzore, në përputhje me mundësitë dhe nevojat sipas parashikimit të strukturës së vitit 2016.

Në lidhje me këtë rast, është dërguar observacion nga institucioni ku ngrihet pretendimi se, për disa nga këta punonjës të Komunës Thumanë, është vendosur ligjshmëria duke u larguar nga shërbimi civil.

Në lidhje me këtë pretendim, Komisioneri konstatoi se, bashkëlidhur observacionit, nuk janë paraqitur prova, të cilat të mbështesin argumentin e institucionit për rivendosjen e ligjshmërisë në këtë rast. Për këtë arsye, verifikimi i pretendimeve do të realizohet gjatë kohës që i është lënë në dispozicion institucionit, për rregullimin e ligjshmërisë në vendimin përfundimtar.

➤ Në 3 raste, punonjësit nuk plotësojnë kriterin arsimor, të cilat janë si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Planifikimit Territorit”, me kontratë punë, datë 06.01.2014;
2. \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Inspektore e Zyrës së DAMT”, me aktin nr. 62/1, datë 03.09.2013;
3. \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve”, emëruar me aktin nr. 78/1, datë 01.10.2013.

Plotësimi i kriterit të nivelit arsimor, është një kërkesë e posaçme për pranimin në shërbimin civil, e përcaktuar në shkronjën “e”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se, një kandidat për nëpunës civil, duhet të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, që në këtë rast është arsim i lartë.

Në këto kushte, kur punonjësit nuk plotësojnë kriterin për të qenë nëpunës civilë, sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke qënë se ndodhemi para rastit që komuna Thumanë përfshihet për herë të parë në shërbimin civil, atëherë, në bazë të pikës 7, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, pasi verifikon për të gjithë punonjësit, problemin e përmbushjes së kriterëve të vendit të punës, nëse konstaton se nuk plotësohet ndonjë prej tyre, vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit.

**Konkluzion:** Komisioneri vlerëson se, në rastin konkret, kur është konstatuar mosplotësimi i kriterit të nivelit arsimor, në bazë të nenit 67 të ligjit për nëpunësin civil dhe të pikës 7, të aktit nënligjor që rregullon procesin e deklarimit të statusit të punësimit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Krujë duhet të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës.

- në **1** rast konstatohet se në momentin e fillimit të efekteve të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pozicioni i punës “Administrator i Zyrës së Ndhmës Ekonomike”, është i paplotësuar.

***b) Situata e zbatimit të detyrimit ligjor për deklarimin e statusit të punësimit, për nëpunësit civil dhe punonjësit ekzistues, nga ana e njësisë përgjegjëse të ish Komunës Thumanë.***

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit, konstatohet se, njësia e administrimit të burimeve njerëzore, pranë Komunës Thumanë, e cila ka pasur funksionet e njësisë përgjegjëse, e për pasojë edhe detyrimin për tu shprehur në lidhje me statusin e punonjësve që fillimi i efekteve juridike të ligjit aktual për nëpunësin civil, i gjeti në pozicione të shërbimit civil, në asnjë rast nuk ka vepruar, ç’ka do të thotë se njësia përgjegjëse, nuk i ka përmbushur detyrimet ligjore në lidhje me realizimin e këtij procesi.

Të gjitha konkluzionet e paraqitura më sipër, janë rezultat i verifikimit të dokumentacionit nga ana e grupit të mbikëqyrjes.

Në lidhje me dosjet e personelit, është konstatuar se në **9** raste mungojnë aktet për verifikimin e gjendjes gjyqësore dhe në **5** raste mungon raporti mjekësor, i cili verifikon gjendjen shëndetësore për punonjësin, në lidhje me mundësinë fizike për të realizuar detyrat.

**Konkluzion:** Nga sa u parashtrua më sipër, Komisioneri vlerëson se për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar, njësia përgjegjëse e Bashkisë Krujë, duhet që të plotësojë dosjet, individuale me të gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me përmbushjen e kërkesave të ligjit dhe të deklarojë statusin e punësimit, për punonjësit e punësuar në pozicionin e punës, pjesë e shërbimit civil, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në nenin 67 të ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore që e specifikojnë procedurat që duhet të kryhen për të zbatuar këtë dispozitë të ligjit dhe sipas rekomandimeve të Komisionerit në këtë raport.

➤ **Komuna Bubq, aktualisht Njësia Administrative Bubq**

Komuna Bubq, aktualisht Njësia Administrative Bubq, është një subjekt i përfshirë për herë të parë në fushën e veprimit të shërbimit civil, me fillimin e efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në momentin e fillimit të mbikëqyrjes, kjo njësi e qeverisjes vendore, ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 6, datë 02.02.2015 të Këshillit të Komunës “Mbi strukturën organizative të qeverisjes vendore të Komunës Bubq dhe Miratimit të nivelit të pagave për vitin 2015”. Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, kjo njësi kishte gjithsej **42** pozicione pune, nga të cilat, **16** pozicione pune, pjesë e shërbimit civil.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë

12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, ndahen në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **5** pozicione pune, që zënë **31 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin kategorisë “Përgjegjës Sektori/ Kryeinspektor/ Administrator”, paga III-b.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **11** pozicione pune, që zënë **69 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin kategorisë “Specialist/Inspektor”, paga III-b.

Nisur nga analiza që i është bërë akteve të emërimit, mbështetur në listë pagesën e muajit shkurt 2014, mbi bazën e strukturës së miratuar në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, si dhe nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, kanë qenë të zëna si më poshtë:

- në **13** raste, punonjësit ekzistues kanë qenë të punësuar në një vend pune pjesë e shërbimit civil, në momentin që kanë filluar efektet juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kanë pasur një periudhë punësimi më tepër se 1 vit, në atë pozicion pune.

Për këtë kategori punonjësish, njësia përgjegjëse, në **12** raste, ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit si nëpunës civilë, me aktet respektive të datës 25.05.2014, dhe në 1 rast e ka nxjerrë aktin në kundërshtim me ligjin, si nëpunëse civile, ndërkohë që sipas kushteve të verifikuara, akti duhet të dilte në kategorinë e nëpunësit civil në periudhë prove.

Sipas problematikës së konstatuar gjatë mbikëqyrjes, këto raste po i trajtojmë në këto nën grupe:

***a. Nëpunës civil të deklaruar që plotësonin kriteret e ligjit;***

Në këtë grupim përfshihen punonjësit, sipas pozicioneve përkatëse të punës, të renditur si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Protokoll-Arkiv” me aktin nr. 22, datë 02.07.2012,
2. \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Përgjegjëse Finance” me aktin nr. 5, datë 04.05.2007,
3. \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Specialiste Kontabiliteti” me aktin nr. 38, datë 01.08.2011,
4. \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave” me aktin nr.37, datë 01.08.2011,
5. \*\*\*\*\*; emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Buqësisë” me aktin nr. 08, datë 04.05.2007,

6. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Inxhinierë Pyjesh*” me aktin nr. 43, datë 01.08.2011,
7. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist Pyjesh*”, me aktin nr. 2, datë 01.03.2012,
8. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Administrator i Shërbimit Social*” me aktin nr. 31, datë 18.07.2011.

**Konkluzion:** Nga sa është pasqyruar më sipër, Komisioneri vlerëson se, në **8** raste, njësia përgjegjëse pranë Komunës Bubq, ka vepruar drejt, kur ka nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të punësimit si nëpunës civilë për atë kategori punonjësish.

Aktet që dokumentojnë këtë proces, janë të evidentuara në tabelën *Aneks nr. 1*, “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*”, Njësia Administrative Bubq.

***b. Punonjës të deklaruar si nëpunës civilë, si dhe të pa deklaruar si të tillë, të cilët nuk përmbushnin kriterin e nivelit arsimor në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil.***

Në këtë grupim përfshihen **5** punonjësit, sipas pozicioneve përkatëse të punës, të renditur si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 12, datë 04.05.2007, në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Tatim Taksave*” dhe deklaruar me aktin e datës 25.05.2014;
2. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 39, datë 01.08. 2011, në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Tatim Taksave*” dhe deklaruar me aktin e datës 25.05.2014;
3. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 48, datë 30.09.2011, në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Shërbimeve*” dhe deklaruar me aktin e datës 25.05.2014;
4. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 2, datë 01.03.2012, në pozicionin “*Specialist Pyjesh*” dhe deklaruar me aktin e datës 25.05.2014;
5. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 16, datë 01.06.2007, në pozicionin e Veterinerit, pozicion i i barazvlerëshëm me pozicionin e punës në nivelin e specialistit, në shërbimin civil, për të cilin nuk është deklaruar statusi i punësimit.

Njësia përgjegjëse ka gabuar duke mos deklaruar statusin e punësimit për këta punonjës dhe më tej, kur nuk ka vepruar, për të ndërprerë marrëdhënien e punës, në kushtet, kur nëpunësit në fjalë nuk plotësonin kriterin arsimor, pasi ishin me arsim të mesëm.

Plotësimi i kriterit të nivelit arsimor, është një kërkesë e posaçme për pranimin në shërbimin civil, e përcaktuar në shkronjën “e”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se, një kandidat për nëpunës civil, duhet të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, që në këtë rast është arsim i lartë.

Në këto kushte, kur punonjësit nuk plotësojnë kriterin për të qenë nëpunës civilë, sipas ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke qenë se ndodhemi para rastit që komuna Bubq, përfshihet për herë të parë në shërbimin civil, atëherë, në bazë të pikës 7, të Vendimit



nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, pasi verifikon për të gjithë punonjësit, problemin e përmbushjes së kriterëve të vendit të punës, nëse konstaton se nuk plotësohet ndonjë prej tyre, vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit.

**Konkluzion:** Komisioneri vlerëson se, në rastin konkret, kur është konstatuar mosplotësimi i kriterit të nivelit arsimor, në bazë të nenit 67, të ligjit aktual për nëpunësin civil dhe të pikës 7, të aktit nënligjor që rregullon procesin e deklarimit të statusit të punësimit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Krujë, duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, duke revokuar aktin e deklarimit të statusit si nëpunës civilë, akte që janë të administruara në dosje pa numër protokoll, për rastet kur ka përfunduar ky proces dhe të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të punësimit, për punonjësin \*\*\*\*\*, për të cilin nuk është realizuar procesi i deklarimit të statusit të punësimit, e më pas të ndërpresë marrëdhënien e punës me institucionin, për të.

Komisioneri konstaton se është bërë observacion nga ana e institucionit në lidhje me këto raste që analizuar më sipër, ku pretendohet se disa prej punonjësve të ish Komunës Bubq, janë larguar nga shërbimi civil, sipas rekomandimeve të lëna në projekt raport.

Në lidhje me këtë pretendim, Komisioneri konstatoi se, bashkëlidhur observacionit, nuk janë paraqitur provat të cilat e mbështesin argumentin e institucionit në këtë rast. Për këtë arsye, verifikimi i këtyre rasteve do të realizohet gjatë kohës që i është lënë në dispozicion njësisë përgjegjëse në vendimin e paralajmërimit, për të sistemuar situatën e shërbimit civil.

Këto pozicione pune duhet të shpallen si të lira dhe të plotësohen në koherencë me strukturën aktuale të institucionit.

➤ **Punonjës të deklaruar si nëpunës civilë, në kundërshtim me ligjin, për arsye se nuk kishin përmbushur afatin 1 vjeçar të punësimit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.**

Konstatohet në 1 rast, (është fjala për punonjësen \*\*\*\*\*), kur punonjësja, e cila ka plotësuar pozicionin e punës, “Përgjegjëse e Urbanistikës”, në datën 01.07.2013 dhe fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur në këtë pozicion, pa mbushur afatin prej 1 viti.

Në këto rrethana, punonjësja në fjalë, duhet të deklarohej nëpunëse civile në periudhë prove, çka është një rregullim specifik, që duhet të kishte nisur ditën e fillimit të efekteve juridike të ligjit aktual për nëpunësin civil, e më tej, njësia përgjegjëse duhet të kujdesej që të plotësonte kërkesat e nenit 24, të këtij ligji.

Veprimi i njësisë së burimeve njerëzore për deklarimin e statusit të punësimit, si nëpunëse civile, me aktin e datës 24.05.2014, pra vetëm tre muaj pas fillimit të periudhës së provës dhe pa plotësuar kërkesën e pikës 4, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i

ndryshuar, për kryerjen e ciklit të trajnimit të detyrueshëm pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA), është një veprim i pabazuar në ligj.

Për këtë arsye, duhet të vendoset ndryshimi i aktit të deklarimit të statusit të punësimit, duke e deklaruar si nëpunëse civile në periudhë prove, deri në plotësimin e pikës 4, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe gjithë kërkesave të tjera të përcaktuara në këtë dispozitë ligjore.

- **Vende pune të plotësuara nga nëpunës që janë emëruar me akte emërimi të përkohshme, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar**

Pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, konstatohet se, në këtë njësi administrative, në **1** rast, punonjësi, \*\*\*\*\*, është punësuar në pozicionin “Jurist”, me aktin e emërimit nr. 1, datë 01.10.2014, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit aktual për nëpunësin civil, duke mos respektuar kërkesat ligjore që përcaktojnë si mënyrën e vetme të punësimit në shërbimin civil, rekrutimin nëpërmjet konkurrimit.

Ndërkohë, konstatohet se, në kundërshtim me ligjin, njësia përgjegjëse, e ka deklaruar statusin e saj të punësimit, si nëpunëse civile, në periudhë prove.

Komisioneri vlerëson se, akti i emërimit në pozicionin e përmendur më sipër, ka dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në bazë të nenit 22 dhe 23 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi.

Në bazë të pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

**Konkluzion:** Në këtë rast, Komisioneri i kërkon njësisë përgjegjëse, që për rregullimin e situatës, të revokojë aktin e emërimit për punonjësen \*\*\*\*\*, si dhe aktin e deklarimit të statusit të punësimit, si nëpunëse civile, në periudhë prove (*i cili ishte administruar në dosje pa numër protokolli*) të nxjerrë për këtë punonjëse në datë 25.05.2015.

Pozicioni i punës i mbajtur nga kjo nëpunëse, duhet të shpallet vend i lirë, me qëllim që të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurrimit, në përputhje me strukturën aktuale të institucionit.

- **Pozicione të lira**

Në **1** rast konstatohet se në momentin e fillimit të efekteve të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, pozicioni i punës “Specialist Finance” është i paplotësuar.

- **Punonjës të deklaruar si nëpunës civil, në kushtet kur pozicioni i punës nuk bën pjesë në shërbimin civil.**

Konstatohet se në **1** rast dhe bëhet fjalë për punonjësin ekzistues \*\*\*\*\*, i cili me aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 67, dt. 25.05.2014, në kundërshtim me ligjin, është deklaruar statusi i punësimit si nëpunës civil, në pozicionin e punës *"Inspektor i INUV"*.

Në këtë rast, ky veprim i njësisë përgjegjëse konsiderohet i kundraligjshëm nga ana e Komisionerit, pasi, punonjësve të INUV, sipas ligjit organik nr. 9780 dt. 16.07.2007 *"Për inspektimin e ndërtimit"*, ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014, u lejohej të mbajnë armë, ç'ka, në referim të nenit 2, të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, nuk i përfshin ata në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil, e për këtë arsye, marrëdhënia e punësimit në këtë rast do të vijojë sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

**Konkluzion:** Komisioneri në këtë rast i kërkon njësisë përgjegjëse, të revokojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, në cilësinë e nëpunësit civil, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës *"Inspektor i INUV"*.

➤ **Komuna Cudhi, aktualisht Njësia Administrative Cudhi**

Kjo njësi administrative, është një subjekt i përfshirë për herë të parë në fushën e veprimit të shërbimit civil, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, (i ndryshuar), si Komuna Cudhi.

Në momentin e fillimit të inspektimit, kjo njësi e qeverisjes vendore, ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 6, datë 20.02.2015 të Këshillit të Komunës *"Për miratimin e strukturës organizative të Komunës Cudhi për vitin 2015"*. Bazuar në këtë strukturë organizative, rezultojnë se, kjo njësi kishte gjithsej **19** pozicione pune, nga të cilat, vetëm **6** pozicione pune, ishin pjesë e shërbimit civil.

Duke bërë klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave *"Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura"*, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, ndahen në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **2** pozicione pune, që zënë **33 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, dhe i përkasin kategorisë *"Përgjegjës Sektori/ Kryeinspektor/ Administrator"*; paga III-b.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **4** pozicione pune, që zënë **67 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës, pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin kategorisë ekzekutive *"Specialist/Inspektor"* dhe rezultojnë se, janë paguar me pagën e punonjësve me arsim të mesëm.

Nisur nga analiza që i është bërë akteve të emërimit, mbështetur në listë pagesën e muajit shkurt 2014, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, si dhe nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4 të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, rezultojnë se në të gjitha rastet

(6 raste), në momentin që kanë filluar efektet juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpunësit kanë qenë të punësuar në të njëjtin pozicion pune, për më tepër se 1 vit.

Njësia përgjegjëse, pasi ka analizuar dokumentacionin që materializon marrëdhënien e punës me institucionin dhe pas ballafaqimit me kërkesat e ligjit, vetëm 1 rast, bëhet fjalë për punonjësin \*\*\*\*\*; ka nxjerrë aktin nr. 184/4 të datës 30.04.2014, për deklarimin e statusit të punësimit, si nëpunës civil, në pozicionin e punës “Inspektor i Financës dhe Tatimeve”, ndërsa, për 5 punonjësit e tjerë, njësia përgjegjëse, nuk është shprehur për statusin e tyre të punësimit.

Punonjësit, për të cilët njësia përgjegjëse, me të drejtë nuk ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, për shkak se këta nuk përmbushnin kriterin e nivelit arsimor, pasi kanë përfunduar vetëm arsimin e mesëm, sipas pozicioneve që kanë plotësuar janë si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*; emëruar me aktin nr. 18, datë 16.07.2011 në pozicionin “Specialist i Pyjeve Komunal”;
2. \*\*\*\*\*; emëruar me aktin nr. 15, datë 21.07.2011 në pozicionin “Specialist i Pyjeve Komunal”;
3. \*\*\*\*\*; emëruar me aktin nr. 11, datë 15.07.2011 në pozicionin “Administrator Shoqëror i Ndihmës Ekonomike”;
4. \*\*\*\*\*; emëruar me aktin nr. 17, datë 21.07.2011 në pozicionin “Specialist i Paaftësisë së Kufizuar”;
5. \*\*\*\*\*; emëruar me aktin nr. 14, datë 21.07.2011 në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Bujqësisë dhe Pyjeve Komunale”.

Në lidhje me nëpunësit në fjalë, në projekt raport është kërkuar informacion, i cili ka të bëjë me nivelin e tyre arsimor, sepse në dosjen e personelit nuk kishte të dhëna në lidhje me këtë aspekt.

Ky informacion, nuk na është vënë në dispozicion me observacionin e dërguar nga institucioni, e as nga vetë nëpunësit e interesuar në këtë rast.

Në këto rrethana, duke u nisur nga fakti i materializuar në listë pagesën e institucionit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit aktual për nëpunësin civil (26.02.2014) ku pasqyrohet se të gjithë këta punonjës kanë marrë pagën e nivelit të arsimit të mesëm, arrihet në përfundimin se, njësia përgjegjëse e Komunës Cudhi, ka vepruar drejt, duke mos i deklaruar si nëpunës civil.

Përmbushja e kriterit të nivelit arsimor, është një kërkesë e posaçme për pranimin në shërbimin civil, apo për konfirmimin e punonjësit si nëpunës civil, e përmendur shprehimisht në germën “e”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku përcaktohet se një kandidat për nëpunës civil, duhet të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, që në rastin konkret është arsim i lartë.

Ndërsa, në rastin e punonjësit \*\*\*\*\*\*, konstatohet se nga pikëpamja formale, njësia përgjegjëse ka vepruar drejt në kryerjen e këtij veprimi administrativ, por nga ana tjetër, në përmbajtje ka gabuar në zbatimin e ligjit.

Kjo, ka të bëjë me faktin se, ky nëpunës, nuk e plotëson kriterin arsimor për të punuar në këtë pozicion. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se ky punonjës ka përfunduar vetëm nivelin “*Bachelor*” në Universitetin “Kristal”, Dega Administrim Biznes, ndërkohë që bazuar në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, në kërkesat e posaçme për arsimin, për pozicionin e punës “*Inspektor Finance e Tatimesh*”, kërkohet që nëpunësi të këtë përfunduar “*Master Shkencor, ose Master Profesional në fushën Ekonomike*”.

Aktet që dokumentojnë administrimin e shërbimit civil në këtë strukturë të subjektit të mbikëqyrur, janë të evidentuara në tabelën **Aneks 1**, “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit, për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*”, Njësia Administrative Cudhi.

**Konkluzion:** Sipas rrethanave të parashtruara më sipër, Komisioneri vlerëson se,

- ✓ nëpunësi \*\*\*\*\*\* nuk mund të kryejë funksionin “*Inspektor Finance e Tatimesh*”, pasi ai nuk e plotëson kriterin e nivelit arsimor, prandaj për këtë arsye, njësia përgjegjëse duhet të revokojë aktin nr. 184/4 dt. 30.04.2014, për deklarimin e statusit të punësimit, si nëpunës civil, në pozicionin “*Inspektor Finance e Tatimesh*”, si dhe të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të nëpunësit civil, e të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës;
- ✓ në rastin e 5 punonjësve, që nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë sipas ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, nuk duhet të mjaftohet me mosdeklarimin e statusit të punësimit, por duhet të vendosë menjëherë, të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të nëpunësit civil dhe përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, ashtu si parashikohet në pikën 7, të Kreut III, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*”.

Komisioneri konstaton se, në observacionin e dërguar nga institucioni ngrihet pretendimi se disa punonjës të ish Komunës Cudhi, janë larguar nga shërbimi civil, sipas rekomandimeve të lëna në projekt raport.

Në lidhje me këtë pretendim, rezulton se bashkëlidhur observacionit, nuk janë paraqitur provat, të cilat duhet të mbështesin argumentin e institucionit në këtë rast.

Për këtë arsye, verifikimi i këtyre rasteve, do të realizohet gjatë kohës që i është lënë në dispozicion institucionit, në vendimin paralajmërues, për të reaguar në lidhje për rregullimin e ligjshmërisë.

➤ **Komuna Nikël, aktualisht Njësia Administrative Nikël**

Kjo njësi administrative, është një subjekt i përfshirë për herë të parë në fushën e veprimit të shërbimit civil, me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), në kushtet kur ka qenë e organizuar si njësi e pushtetit vendor, Komuna Nikël.

Në momentin e kryerjes së inspektimit, kjo njësi e qeverisjes vendore, ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 35, datë 29.12.2014 të Këshillit të Komunës “Për miratimin e strukturës organizative të Komunës Nikël për vitin 2015”. Sipas kësaj strukture organizative, rezulton se, institucioni i mbikëqyrur kishte gjithsej **43** pozicione pune, nga të cilat, **17** janë pjesë e shërbimit civil.

Duke bërë klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ato ndahen në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **6** pozicione pune, që zënë **37 %** të vendeve të punës, në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës, pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin kategorisë “Përgjegjës Sektori/Kryeinspektor/Administrator”; paga III-b.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **11** pozicione pune, që zënë **63 %** të vendeve të punës, në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës, pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin kategorisë “Specialist/Inspektor”, të cilët rezulton se janë paguar në kategorinë e pagës së punonjësve me arsim të mesëm.

Nisur nga aktet e emërimit dhe mbështetur në listë pagesën e muajit shkurt 2014, mbi bazën e strukturës efektive në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe bazuar në pikat 3 dhe 4, të nenit 67, të këtij ligji, pozicionet dhe kohëzgjatja e punësimit në të njëjtin pozicion, paraqitet si më poshtë:

- **11** prej punonjësve ekzistues, kanë qenë të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë kohore më tepër se 1 vit.

Në lidhje me këto raste, (s qarojmë se 2(dy) raste janë shtuar në këtë rubrikë, ndryshe nga projekt raporti për këtë kategori, që përcaktonte 9 raste, në kushtet kur është marrë parasysh prej Komisionerit, observacioni i institucionit, ne lidhje me punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*) konstatohet se njësia përgjegjëse, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë, me aktet respektive të datës 03.10.2014, vetëm për **9** punonjës, ndër të cilët :

1. \*\*\*\*\*, emëruar me kontratë pune në datë, 09.06.2008, në pozicionin “*Jurist*”;
2. \*\*\*\*\*, emëruar me kontratë pune në datën 16.01.2009, në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Financës*”;
3. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 39, datën 01.09.2011, në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Bujqësisë*”;
4. \*\*\*\*\*, emëruar me kontratë pune datën 04.01.2013, në pozicionin “*Inspektor Bujqësie*”;
5. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 2/2, datën 12.11.2012, në pozicionin “*Inspektor Pyjesh*”;
6. \*\*\*\*\*, emëruar me kontratë pune në datën 05.01.2012, në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës Ekonomike*”;
7. \*\*\*\*\*, emëruar me kontratë pune në datën 03.01.2012, në pozicionin “*Përgjegjëse e Sektorit të Planifikim Territorit*”.
8. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 02, datë 24.01.2013, në pozicionin “*Inspektore e Shërbimit Social*”;
9. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 04, datë 24.01.2013, në pozicionin “*Inspektor i Tatim Taksave*”.

Në lidhje me këto raste, gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se punonjësit i përmbushin kriteret për t'u deklaruar si nëpunës civilë, si një e drejtë që ka lindur për shkak të ligjit, sipas përcaktimeve të dispozitës ligjore të materializuar në nenin 67, të ligjit aktual për nëpunësin civil.

Në mënyrë të hollësishme, aktet që dokumentojnë këtë proces dhe gjithë procesin e administrimit të shërbimit civil në këtë pjesë të strukturës së bashkisë Krujë, janë të evidentuara në tabelën *Aneks nr.1*, “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Njësia Administrative Nikël.*

**Konkluzion:** Nga sa u analizua më sipër, Komisioneri vlerëson se në **9** raste, njësia përgjegjëse e Komunës Nikël, ka vepruar drejt, duke nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë, për këtë kategori punonjësish.

Ndërkohë, për **2** punonjësit e kësaj kategorie, të cilët kanë më shumë se një vit, në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit aktual për nëpunësin civil,

- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Inspektor Finance*”, me kontratë pune në datën 16.01.2009,
- ✓ \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Inspektor i Urbanistikës*”, me Urdhrin nr. 38, datë 01.12.2003,

konstatohet se, njësia e personelit, nuk ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, me pretendimin se këto pozicione pune nuk konsiderohen pjesë e shërbimit civil.

Në lidhje me këto raste, Komisioneri çmon se, arsyetimi i njësisë së burimeve njerëzore, që ka të bëjë me vlerësimin e këtyre pozicioneve, në raport me shërbimin civil, është i gabuar, pasi duke u bazuar në germën “c”, të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, arrihet në përfundimin se pozicionet e mësipërme të punës, janë të asaj natyre që lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e autoritetit publik, me zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, ekzekutimin e tyre, karakteristika këto që përbëjnë elementet e një funksioni në shërbimin civil.

Ndërkohë, Komisioneri konstaton se, gjatë mbikëqyrjes ka rezultuar se, punonjësit që i kanë plotësuar këto pozicione, nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë, për shkak se janë me arsim të mesëm, në një kohë që, për të punuar në këto pozicione të nivelit të administrimit të posaçëm, kërkohet arsimi i lartë. Konstatohet gjithashtu se, këta punonjës, vijojnë edhe aktualisht të kryejnë detyrat funksionale në pozicionet përkatëse.

**Konkluzion:** Nga sa u analizua më sipër, Komisioneri kërkon nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Krujë, që për punonjësit e mësipërm, të cilët vijojnë të kryejnë detyrat funksionale në pozicionet përkatëse, të vendoset refuzimi i deklaramit të statusit të nëpunësit civil dhe përfundimi i marrëdhënies së punësimit, duke evidentuar faktin se punonjësit, nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë dhe këto pozicione të shpallen të lira, për t'u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, duke u vlerësuar kjo, në përputhje me nevojat që do të diktohen prej strukturës së vitit 2016.

➤ Siç del nga dokumentacioni i administruar, veç punonjësve të mësipërm që kanë fituar statusin e punësimit, si nëpunës civilë, për shkak se kishin më shumë se një vit në të njëjtin pozicion pune, 5 prej punonjësve ekzistues, në momentin që kanë filluar efektet juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kanë qenë të punësuar në pozicionet e tyre të punës për një periudhë më pak se 1 vit

*(Sqarojmë se, 2(dy) raste, janë hequr në këtë rubrikë, ndryshe nga projekt raporti për këtë kategori, që përcaktonte 7 raste, në kushtet kur është marrë parasysh prej Komisionerit, observacioni i institucionit, në lidhje me punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*.)*

Këta punonjës, normalisht, në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhej të kishin përfituar statusin e punësimit “nëpunës civil në periudhë prove”, nëse i përmbushnin kërkesat ligjore, por njësia përgjegjëse, ka gabuar në dy drejtime:

- a) Për punonjësin \*\*\*\*\* , pa të drejtë, ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit si nëpunës civilë, ndërkohë që duhet të deklarohej me statusin “nëpunës civil në periudhë prove”, duke anashkaluar në këtë mënyrë, detyrimet ligjore që parashikohen në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”. i ndryshuar.

Në këtë moment duhet të analizojmë observacionet e institucionit, që kanë lidhje me konstatimet e grupit të mbikëqyrjes dhe administrimit të dokumentacionit.



Në përmbajtjen e projekt raportit, i cili i është dërguar për njohje institucionit, është parashtruar se, pas verifikimit të dokumentacionit përkatës, për të tre këta punonjës, rezulton se, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, ata kanë pasur një periudhë punësimi më pak se një vit kohë, në të njëjtin pozicion pune.

Konkretisht, punonjësit,

- ✓ \*\*\*\*\*, si "*Inspektor Buxheti*", emëruar dhe ka filluar punën, në datën 03.02.2014 dhe është deklaruar statusi i punësimit si nëpunës civil, me aktin nr. 1141, datë 03.10.2014;
- ✓ \*\*\*\*\*, si "*Inspektor i Bujqësisë (Veteriner)*", emëruar dhe ka filluar punën me aktin nr. 28, datë 01.04.2013 dhe është deklaruar statusi i punësimit si nëpunës civil, me aktin nr. 1146, datë 03.10.2014;
- ✓ \*\*\*\*\*, si "*Inspektore në Sektorin e Ndihmës Ekonomike*", emëruar në datën 03.02.2014 dhe është deklaruar statusi i punësimit si nëpunës civil, me aktin nr.1140, datë 03.10.2014.

Në këto rrethana, në projekt raport është arritur në konkluzionin se njësia e burimeve njerëzore, pa të drejtë i ka trajtuar këta nëpunës, si nëpunës civilë, pasi në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar, ata duhet të deklaroheshin si "*nëpunës civilë në periudhë prove*".

Ndërkohë, Komisioneri konstaton se në lidhje me këto raste, u paraqitën observacione nga institucioni, shoqëruar me provat përkatëse, duke pretenduar, se këta punonjës i plotësojnë kushtet për të qënë nëpunës civil.

Në këto rrethana, Komisioneri, pasi vlerësoi provat e paraqitura, konstatoi se marrëdhënia e punës me institucionin, për dy nga këta punonjës, ka filluar përkatësisht:

- për punonjësen \*\*\*\*\*; me aktin nr. 02, datë 24.01.2013, në pozicionin "*Inspektore e Shërbimit Social*";
- për punonjësin \*\*\*\*\* me aktin nr. 04, datë 24.01.2013, në pozicionin "*Inspektor i Tatim Taksave*".

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se bëhet fjalë për pozicione pune të nivelit ekzekutiv dhe punonjësit në fjalë kanë punuar më shumë se një vit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, prandaj, referuar nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, konkluzioni i projekt raportit do të ndryshojë, duke i konsideruar këta punonjës, për shkak të ligjit, si nëpunës civil, e për këtë arsye ata i shtohen grupimit të nëpunësve civilë, të deklaruar në mënyrë të rregullt.

Ndërkohë, për rastin e nëpunësit \*\*\*\*\*; Komisioneri vlerëson se nuk provohen pretendimet e ngritura nga ana njësisë përgjegjëse dhe për këtë arsye, duhet të qëndrojë i njëjti përfundim që ka dalë në projekt raport dhe punonjësi duhet të deklarohet si nëpunës civil në periudhë prove.

**Konkluzion:** Sa më sipër, me qëllim rregullimin e ligjshmërisë, në kushtet kur punonjësi E. Maloku, ka pasur më pak se një vit, në këtë pozicion pune, njësia përgjegjëse duhet të ndryshojë aktin e deklaramit të statusit të punësimit, duke e vlerësuar statusin e tij, si “*nëpunës civil në periudhë prove*”. Në zbatim të kërkesave ligjore në këtë rast, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që të respektohen ato, duke përfshirë detyrimet që rrjedhin nga neni 24, i ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

- b) Për 4(katër) punonjësit e tjerë, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, konstatohet se njësia përgjegjëse ka refuzuar nxjerrjen e aktit të deklaramit të statusit të punësimit, me arsyetimin se pozicionet e tyre të punës, nuk përfshihen në fushën e shërbimit civil.

Duke u nisur nga verifikimet e kryera për këto raste, rezulton se për punonjësit,

- ✓ \*\*\*\*\*, “*Përgjegjës i Shërbimeve*”, emëruar në këtë detyrë me kontratë pune në datën 03.02.2014;
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Inspektor i Arsimit dhe Shëndetësisë*”, emëruar në këtë pozicion me kontratë pune, në datën 03.02.2014;
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Përgjegjës i Sektorit Tatim Taksave*”, emëruar në këtë pozicion me kontratë pune, në datën 03.02.2014;
- ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist Tatim Taksa*”, emëruar në këtë pozicion me kontratë pune, në datën 03.02.2014,

njësia përgjegjëse nuk ka nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të punësimit, me arsyetimin se pozicionet përkatëse të punës nuk përfshihen në shërbimin civil.

Komisioneri vlerëson se, arsyetimi i njësisë së burimeve njerëzore, për këto pozicione, në raport me shërbimin civil, është i gabuar, pasi në bazë të pikës “c” të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pozicionet e mësipërme të punës, janë të asaj natyre që lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e autoritetit publik, me zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, ekzekutimin e tyre, karakteristika këto që përbëjnë elementet e një funksioni në shërbimin civil.

Ndërkohë, nga ana tjetër, Komisioneri konstaton se punonjësit që i plotësojnë këto pozicione pune, nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë, për arsye se ata kanë kryer vetëm nivelin e arsimit të mesëm shkollor, në një kohë që, në këto pozicione të nivelit të administrimit të posaçëm, kërkohet arsimi i lartë. Konstatohet gjithashtu se, këta punonjës, vijnë ende, të kryejnë detyrat funksionale në pozicionet përkatëse.

**Konkluzion:** Nga sa u analizua më sipër, Komisioneri, i kërkon njësisë përgjegjëse të Bashkisë Krujë, që të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të ëpunësit civil dhe të përfundojë marrëdhënien e punësimit për këta punonjës, duke evidentuar faktin se ata nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë dhe këto pozicione të shpallen të lira, për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, duke u vlerësuar kjo, në përputhje me nevojat që do të diktohen prej strukturës së vitit 2016.

Komisioneri analizoi observacionin e dërguar nga institucioni në këtë rast, ku ngrihet pretendimi se disa punonjës të ish Komunës Nikël, aktualisht janë larguar nga shërbimi civil, sipas rekomandimeve të lëna në projekt raport.

Në lidhje me këtë pretendim, Komisioneri konstatoi se, bashkëlidhur observacionit nuk janë paraqitur provat të cilat mbështesin argumentin e institucionit, e për këtë arsye verifikimi i këtyre rasteve do të realizohet gjatë kohës që i është lënë në dispozicion institucionit, në vendimin e paralajmërimit, për të reaguar në lidhje me rregullimin e situatës.

- Vende pune të plotësuara nga nëpunës që janë emëruar me akte emërimi të përkohshme, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar

Pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, konstatohet se, në këtë institucion, në 1 rast, është marrë në punë një punonjës me akt emërimi të përkohshëm. Bëhet fjalë për punonjësin \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin "Inspektor i Ndihmës Ekonomike", me aktin nr. 33, datë 01.06.2015, të Kryetarit të Bashkisë.

Akti i emërimit në pozicionin e përmendur më sipër, ka dalë në kundërshtim me ligjin, i cili kërkon që për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, bëhet duke u bazuar në procedurën e përcaktuar në nenet 22 dhe 23 të këtij ligji. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

**Konkluzion:** Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, për rregullimin e situatës, njësia përgjegjëse, duhet të revokojë menjëherë, aktin e emërimit për punonjësen \*\*\*\*\* dhe të përfundojë marrëdhënien e punës me institucionin.

Pozicioni i punës "Inspektor i Ndihmës Ekonomike" duhet të shpallet vend i lirë, me qëllim që të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurrimit, në përputhje me nevojat e strukturës së re të vitit 2016.

### **III. Respektimi i afatit ligjor për deklarimin e statusit të punësimit**

Në zbatim të pikës 8, të nenit 67, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, është miratuar Vendimi nr. 116, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", Kreu II "Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet", me anë të të cilit përcaktohen procedurat e hollësishme për zbatimin e nenit të sipërcituar.

Në interpretim të pikës 1, Kreu IV "Dispozita Transitore", të këtij akti nënligjor, rezulton se, procedura e deklarimit të statusit të punësimit është kryer nga njësiti përgjegjëse, në afatin e përcaktuar në ligj, citojmë dispozitën ligjore "Procedura e deklarimit të statusit të punësimit përfundon jo më vonë se 120 (njëqind e njëzet) ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi".

Ky proces rregullohet në mënyrë të hollësishme edhe me Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ku i ngarkohet njësisë përgjegjëse të institucionit të mbikëqyrur, përgjegjësia për të lëshuar për çdo nëpunës, Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit, sipas përcaktimeve të ligjit; përcaktohet afati për përfundimin e procedurës së deklarimit jo më vonë se 120 (njëqind e njëzet) ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si dhe lejon të drejtën e shtyrjes së këtij afati, një herë të vetme, për shkaqe të arsyeshme, jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë.

Procesi i deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve të Bashkisë Krujë, të cilët ushtrojnë funksione të shërbimit civil, është kryer në muajin qershor të vitit 2014, afërsisht në limitet e afatit ligjor të përcaktuar në ligj.

Procesi i deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve të Bashkisë së Fushë – Krujës, të cilët ushtrojnë funksione të shërbimit civil, është realizuar në muajin prill të vitit 2014, brenda afatit ligjor të përcaktuar në ligj.

Procesi i deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve të Komunës Cudhi, të cilët ushtrojnë funksione të shërbimit civil, është kryer në muajin prill të vitit 2014, brenda afatit ligjor të përcaktuar në ligj.

Procesi i deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve të Komunës Bubq, të cilët ushtrojnë funksione të shërbimit civil, është kryer në muajin prill të vitit 2014, brenda afatit ligjor të përcaktuar në ligj.

Procesi i deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve të Komunës Nikël, të cilët ushtrojnë funksione të shërbimit civil, është realizuar në muajin tetor të vitit 2014, jashtë afatit ligjor të përcaktuar në ligj.

Ndërkohë, Komuna Thuman, nuk e ka realizuar deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit që u gjetën në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit aktual për nëpunësin civil.

Për këtë arsye, kjo detyrë i kalon njësisë përgjegjëse të Bashkisë Krujë, për të përmbyllur këtë proces, për punonjësit e kësaj strukture, e cila aktualisht është njësi administrative e Bashkisë Krujë.

#### **IV. Trajtimi i disa çështjeve të veçanta, të cilat i janë bërë prezent Komisionerit nga nëpunës të institucionit të mbikëqyrur, gjatë procesit të mbikëqyrjes.**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin e Bashkisë Krujë, është njohur me disa pretendime të punonjësve të subjektit të mbikëqyrur, në lidhje me parregullsi në momentin e implementimit të strukturës së re të institucionit, si rezultat i ndryshimeve administrativo – territoriale, në Njësitë Administrative, Bubq dhe Cudhi.

Në lidhje me këto raste, grupi i punës, verifikoi situatën dhe në përfundim të këtij procesi, rezultoi si më poshtë:

### ***1. Verifikimi i informacionit të ardhur nga punonjësja \*\*\*\*\****

Nëpunësja \*\*\*\*\* , nëpërmjet informacionit të regjistruar, me nr. 711, datë 21.10.2015, pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka parashtruar se ka qenë punonjëse e Komunës Bubq, në pozicionin e punës *“Përgjegjëse e Zyrës së Shërbimeve”*, emëruar me aktin nr. 42, datë 01.08.2011 dhe për shkak se fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil” i ndryshuar*, e ka gjetur në këtë pozicion pune, është deklaruar si nëpunëse civile, në datën 25.05.2014.

Me shkresën nr. 1947/2, datë 28.09.2015, kjo punonjëse është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, një muaj pas daljes së këtij akti, për shkak të ristrukturimit të institucionit, proces që ka sjellë edhe shkrirjen e pozicionit të punës *“Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve”*. Megjithatë, nëpunësja në fjalë, pretendon se ky pozicion pune nuk është shkrirë, por mbahet padrejtësisht, nga një person tjetër.

Duke analizuar këtë pretendim, si dhe duke shqyrtuar dokumentacionin e mbledhur në kuadrin e verifikimit të këtij rasti, rezulton se me Urdhrin nr. 71, datë 15.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, *“Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën tranzitore”*, është miratuar struktura e Bashkisë Krujë dhe Njësive Administrative në varësi të saj.

Në këtë strukturë, Njësia Administrative Bubq, rezulton me ulje të numrit të përgjithshëm të punonjësve, duke ndryshuar nga **42**, në **24** pozicione pune dhe se pozicioni i punës *“Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve”*, nuk ekziston më.

Nisur nga kjo situatë, kur në përgjithësi kemi shkurtim të numrit të punonjësve, e në veçanti shkrirje të pozicionit të punës, ku ka qenë e punësuar nëpunësja \*\*\*\*\* , në pamundësi për ta transferuar, sipas pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil” i ndryshuar*, ndodhemi në kushtet e ristrukturimit të institucionit.

Në bazë të pikës 3, të kësaj dispozite, njësia përgjegjëse duhet të ngrinte Komisionin e Ristrukturimit, i cili do të shqyrtonte mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi në vendet e tjera, të lira ekzistuese.

Ky mekanizëm do të paraqiste propozimet e tij për transferimin e nëpunësit në një pozicion tjetër të lirë, në të cilin ai i plotësonte kërkesat specifike, sipas radhës, së përcaktuar në pikën 2, të dispozitës në fjalë.

Vetëm në rast pamundësie të plotë për një transferim të tillë, mund të vendosej përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, por gjithmonë duke mbajtur parasysh, plotësimin e mundësive që jep pika 8, e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Brenda një periudhe 2-vjeçare punonjësi i liruar të mund të konkurrojë si nëpunës civil, për procedurat e lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë sipas neneve 25 e 26, të këtij ligji, apo të emërohet në mënyrë të përkohshme në pozicione të shërbimit civil, me pëlqimin e tij.

Përfundimisht, në rastin konkret, konstatohet se nuk janë zhvilluar procedurat ligjore në një rast ristrukturimi, e për këtë arsye, nga ana e njësisë përgjegjëse, duhet të merren masat për të revokuar aktin nr. 1947/2, datë 28.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për nëpunësen \*\*\*\*\* dhe të fillojë kryerja nga e para e para e procedurës së parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 171 dt. 26.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”.

## **2. Verifikimi i informacionit të ardhur nga punonjësi \*\*\*\*\***

Në rastin e nëpunësit \*\*\*\*\* , nëpërmjet ankesës nr. 870, datë 02.12.2015, paraqitur pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është parashtruar se, me aktin nr. 13, datë 19.07.2011, ai është emëruar punonjës i Komunës Cudhi, në pozicionin e “Inspektorit të Financës e Tatimeve”.

Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur punonjësin në pozicionin e inspektorit, për një periudhë më shumë se një vit dhe për këtë arsye, njësia përgjegjëse e komunës, e ka deklaruar si nëpunës civil, me aktin nr. 184/4, datë 30.04.2014.

Me shkresën nr. 1943/2, datë 28.09.2015, punonjësi është njoftuar nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Krujë, se 1 muaj mbas datës së daljes së aktit në fjalë, do t’i ndërpriten marrëdhëniet e punës, për shkak të mos plotësimit të kërkesave të vendit të punës, për shkak ristrukturimi.

Duke analizuar provat e administruara në këtë rast, evidentohet fakti se ristrukturimi i institucionit, ka sjellë edhe shkurtim real të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civil dhe për këtë arsye, transferimi sipas pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 të ndryshuar, ka qenë i pamundur të aplikohet për këtë punonjës.

Megjithatë, nëpunësi në fjalë pretendon se, përderisa pozicioni i punës “Inspektor i Financës dhe Tatimeve”, me strukturën e re të miratuar me Urdhrin nr. 71, datë 15.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, nuk është shkurtuar, atëherë ai duhet të vazhdojë të kryejë këtë funksion, pranë Njësisë Administrative Cudhi dhe për të realizuar të drejtat e tij, ai ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit.

Në kuadër të realizimit të procesit të mbikëqyrjes në Njësinë Administrative Cudhi, si pjesë përbërëse e Bashkisë Krujë, u trajtua edhe informacioni i ardhur nga ky punonjës dhe pas verifikimit, rezultoi e provuar se ai, ka filluar marrëdhënien e punës në Komunën Cudhi, me aktin e emërimit nr. 13, datë 19.07.2011, në pozicionin e punës “Inspektor i Financës e Tatimeve”. Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur punonjësin në të njëtin pozicion, e për këtë shkak, njësia e personelit, me aktin

nr.184/4, datë 30.04.2014, ka realizuar deklarin e statusit të punësimit si nëpunës civil, në pozicionin "Inspektor Finance e Tatimesh".

Në këtë rast konstatohet se nga pikëpamja formale, njësia përgjegjëse ka vepruar drejt në kryerjen e këtij veprimi administrativ, por nga ana tjetër, në përmbajtje ka gabuar në zbatimin e ligjit.

Ky përfundim, ka të bëjë me faktin se, nëpunësi \*\*\*\*\*, nuk e plotëson kriterin arsimor për t'u deklaruar si nëpunës civil në këtë pozicion pune. Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se ky punonjës ka përfunduar nivelin e parë të studimit e larta dhe aktualisht në dosje është e administruar diploma "Bachelor", në Universitetin "Kristal", Dega Administrim Biznes.

Duke vazhduar analizën e rastit, në zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", në kërkesat e posaçme për arsimin, për pozicionin e punës "Inspektor Finance e Tatimesh", kërkohet që nëpunësi të këtë përfunduar: "Master Shkencor ose Master Profesional në fushën Ekonomike".

Në këto kushte, ky punonjës nuk i përmbush kriteret për t'u deklaruar si nëpunës civil, e më tej për të vazhduar të punojë në pozicionin që ai pretendon. Për këtë arsye, institucioni nuk ka asnjë detyrim që ta risistemojë atë në një pozicion tjetër pune, pjesë e shërbimit civil, pas ristrukturimit.

**Konkluzion:** Komisioneri, duke arsyetuar sipas fakteve të parashtruara më sipër, vlerëson se nëpunësi \*\*\*\*\* nuk mund që ta kryejë funksionin në pozicionin "Inspektor Finance e Tatimesh", për arsye se ai nuk e përmbush kriterin e nivelit arsimor, që në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit aktual për nëpunësin civil.

Për këtë shkak, njësia përgjegjëse duhet të revokojë Urdhrin nr. 184/4 dt. 30.04.2014, për deklarin e statusit të punësimit, si nëpunës civil, në pozicionin "Inspektor Finance e Tatimesh", e më tej të ndryshojë motivacionin e aktit nr. 1943/2, datë 28.09.2015, për ndërprejen e marrëdhënieve të punës, duke shënuar si shkak të ndërprerjes, faktin e mosplotësimit të kriterit arsimor, në momentin e deklarin të statusit të punësimit.

c) **Hartimi i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil për Bashkinë Krujë, dhe Njësitë Administrative Fushë-Krujë, Thuman, Cudhi, Bubq dhe Nikël.**

Një institut shumë i rëndësishëm, i cili ka lidhje me një sërë institutesh të tjera të ligjit për nëpunësin civil, të tillë si rekrutimi, ristrukturimi, vlerësimi i punës, sistemi i karrierës etj., është edhe procesi i hartimit të përshkrimit të punës, për pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil.

Nga verifikimi u konstatua se, për pozicionet e punës në shërbimin civil, nuk janë hartuar përshkrimet e punës, sipas formatit standard të miratuar, ashtu si përcaktohet në Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” dhe lidhjes 4, bashkëlidhur këtij akti nënligjor.

Nisur nga përmbajtja e tij si dhe e Udhëzimit nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”, si akte nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, rezulton se në to, janë të përcaktuara me hollësi procedurat për hartimin e përshkrimit të punës për çdo pozicion që përfshihet në shërbimin civil.

Akti i përshkrimit të punës, duhet të përmbajë jo vetëm detyrat e nëpunësit, por edhe vendin që zë pozicioni në sistemin e shërbimit civil të institucionit, pra pozicioni organizativ, pozicionimi në shkallën përkatëse, misioni i institucionit, qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës, përgjegjësia për organizimin e punës dhe detyrat kryesore, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, mjedisi menaxherial, mbikëqyrja, stafi në varësi (në rastet kur ka), kushtet e punës, kërkesat e posaçme dhe nënshkrimi.

Nga mbikëqyrja rezulton se këta elementë të rëndësishëm që kanë një vlerë të veçantë, sidomos për të kontrolluar aktivitetin e nëpunësit, si dhe për të vlerësuar performancën e punonjësit, për të bërë sa më efektiv sistemin e vlerësimit të punës së tij, në fund të vitit kalendarik, si një detyrim ligjor, duhen pasur parasysh gjatë procesit të hartimit të formularëve të përshkrimit të punës në këtë institucion.

Gjithashtu, duhet ndjekur procedura e njoftimit të aktit, pasi përshkrimi i punës duhet të jetë i nënshkruar nga të gjithë personat e ngarkuar nga ligji, si pjesë e këtij procesi dhe nga vetë punonjësit, në rubrikat përkatëse.

**Konkluzion:** Sa më sipër, Komisioneri i kërkon njësisë përgjegjëse të Bashkisë Krujë, të hartojë menjëherë përshkrimet e punës për pozicionet e përfshira në shërbimin civil, sipas formatit të miratuar, në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” dhe lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”.

\*

\* \*

Këto ishin rrethanat e konstatuara nga Komisioneri, gjatë mbikëqyrjes në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Krujë, në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore të deklaramit të statusit të punësimit, të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit*”.



*nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, (ndryshuar me Vendimin nr. 532, datë 06.08.2014 të Këshillit të Ministrave), si dhe disa aspekte të lidhura me këtë institut të ligjit.*

Të gjitha aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, në njësitë që e përbëjnë aktualisht këtë subjekt të mbikëqyrjes, në Bashkinë Krujë, Njësitë Administrative Fushë - Krujë, Thumanë, Bubq, Cudhi dhe Nikël, janë materializuar në tabelat:

**Aneksi nr.1** *“Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”.*

**Aneksi nr.2** *“Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil”.*

Njësia përgjegjëse duhet të marrë masat për të realizuar detyrat e lëna nga Komisioneri, në vendimin e paralajmërimit, brenda afatit kohor të vendosur në të, për të rregulluar situatën e administrimit të shërbimit civil në këtë institucion.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**